

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 192, Tetor 2019
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1,5 euro

"FEST FOLK - KLOSI - 2019", NJË BUQETË E NEKTAR TË MBARË NACIONAL

Me datën 13 tetor 2019 në një ditë rrezellitëse me diell pranveror Qyteti i Klosit u lulëzua nga një dekori shumëngjyrëshë i kostumeve më larmishme të traditës sonë nacionale. Në orën 10-të për plot 60 minuta një armatë e gjerë prej 14 grupesh folklorike këngëtare, valltare dhe instrumentist nga mbarë trojet shqiptar parakaluan dhe vallëzuan nën ritmin e daulleve, klarinetës e gajdeve përgjatë shëtitores së qytetit deri tek Bashkia të përshëndetur dhe duartrokatur nga qindra qytetare përgjatë trotuareve të rrugës, por edhe oborreve dhe ballkoneve të banesave të tyre. Ky zbarkim flakëruës dhe fotozhenik i artistëve popullor të folkut nuk ishte spontan por i mirë organizuar në çdo detaj. Të gjithë të ftuarit u gjendën bashkërisht para urimit mirëseardhës të zotëve të shtëpisë (organizatorëve) Zyra e Arsimit dhe Kulturës Bashkia Klos dhe Grupi Folklorik "Petralba" Klos u ftuar dhe mbështetur nga kryetari i Bashkisë së Klos, zoti Ilmi Hoxha.



MIGJENI "RIKTHEHET" MES NESH

Sot përjetova, personalisht, një ditë mjaft mbresëlënëse, si një zë modest i letrave shqipe, veçmas si studiues i Migjenit.

Në këtë 12 tetor 2019, në ora 10.00, Shkodra përcollti një ditë të veçantë, që do ta quaja: "Një hap i Shkodres drejt vetvetes".

12 TETORI 2019, një ditë përpara lindjes së MIGJENIT, ndryshe në 108 vjetorin e lindjes së poetit tonë të madh, prej së cilës brezi i ri, që lind e rritet, sidomos, në Shkodër, do të mësojë ku banoi poeti ynë i përmasave evropiane, poeti ynë pa paraardhës dhe pa pasardhës, siç shprehet eruditi dr. Moikom Zeqo, poeti që u kryqëzua, si dikur Fishta e Mjeda, nga verbëria parapolitike provinciale, do të mësojë shtëpinë ku banoi poeti ynë i shtrenjtë që ajo shtëpi...

MASAKRA E KHANIT NË 75 - VJETORIN E KUJTESËS!

Në prag të 75 vjetorit të masakrës të terrorit komunist të 10 malësoreve nga fshati Khan, Dajçë e Shosh, në Qafë Thanë të Bruçajve u vendos memorial i kujtesës me emrat e të pushkatuarve, sot dëshmor të demokracisë. Në çdo kohë kush ka luftuar kundër pushtuesve të huaj, janë yje të pashuar në altarin e Atdheut e të Kombit shqiptar përfshi dhe dëshmorët e luftës nacional - çlirimtare. Këta të fundit duhet pastruar nga krimet dhe kriminelët vëlla-vrasës që bënë në emër të luftës kundër reaksionit për të garantuar pushtetin e vetëm komunist të pas çlirimit.

FESTA NACIONAL E AUSTRISË

Tani u bë traditë, që çdo vit në Shkodër, nën drejtimin zotit Gjergj Leqjeza, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë, të mbledhemi në mjediset e Hotel "Rozafa" të festojmë Festën Kombëtare të Austrisë. Pra, edhe këtë vit, si përhera, me datën 22 tetor 2019, u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit në Shkodër, i Republikës së Austrisë, zoti Gjergj Leqjeza dhe bashkë me të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Republikës së Austrisë, zotin Christian Steiner në Tiranë...

MULLINJTE E ERËS SË DON KISHOTËVE SHQIPTARË!

Këto ditë po shihja intervistën e fundit të dhënë për një media Shqiptare të Mbretëreshës Geraldine të Shqipërisë, edhe dëshira e saj më e madhe ishte të ndërronte jetë në Shqipëri. Fatmirësisht 4 muajt e fundit të jetës së saj i kaloi në Shqipëri, të mendosh se kjo dëshirë kaq e zjarrtë nuk ishte nga një Shqiptare, por ajo shprehet se ajo ishte mbretëreshë e Shqiptarëve dhe ju përket atyre, në emër të neve dhe e tillë ndihej.

“FEST FOLK - KLOSI - 2019”, NJË BUQETË E NEKTAR TË MBARË NACIONAL

Me datën 13 tetor 2019 në një ditë rrezellitëse me diell pranveror Qyteti i Klosit u lulëzua nga një dekori shumëgjyreshe i kostumeve më larmishme të traditës sonë nacionale. Në orën 10-të për plot 60 minuta një armatë e gjerë prej 14 grupesh folklorike këngëtare, valltare dhe instrumentist nga mbarë trojet shqiptar parakaluan dhe vallëzuan nën ritmin e daulleve, klarinetës e gajdeve përgjatë shëtitores se qytetit deri tek Bashka të përshëndetur dhe duartrokatur nga qindra qytetare përgjatë trotuareve të rrugës, por edhe oborreve dhe ballkoneve të bane-save të tyre. Ky zbarkim flakëruar dhe fotozhenik i artistëve popullor të folkut nuk ishte spontan por i mirë organizuar në çdo detaj. Të gjithë të ftuarit u gjendën bashkërisht para urimit mirëseardhës të zotëve të shtëpisë (organizatorëve) Zyra e Arsimit dhe Kulturës Bashkia Klos dhe Grupi Folklorik “Petralba” Klos, ideuar dhe mbështetur nga kryetari i Bashkisë Klos, zoti Iلمي Hoxha.

Në orën 11-të ansamblet dhe grupet folklorike nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i zi dhe Diaspora, pushtuan skenën madhështore të ngritur në qendër të qytetit, e cila përhapoi oshtimën veprimtarinë e dytë të Festivalit Folklorik Mbarënational, “Fest-Folk Klosi-2019”. “Fest Folk Klosi -2019”, erdhi si një buqete begatë afreskesh, erdhi si një manifest i vlerave të trashëgimisë kulturore e shpirtërore të trevave mbarë shqiptare: Morën pjesë shoqëri kulturore-artistike dhe grupe folklorike të trojeve të banuara nga shqiptarë, andej e këtej kufirit. Podin e festivalit u ngjiten dhe garuan Grupi folklorik “Fatmir Berisha” Klinë, Grupi folklorik “Gurrat e Kurbinit”, Grupi folklorik “Selman Kadria” Istog, Grupi folklorik “Kukësi” QKA “Anamorava”, Qendra kulturore Bulqizë, Grupi folklorik “Ferizaj”, Shoqata kulturore “Besa Shosh” Dukagjin, ShKA Zëri Llapushicës Melishev, SHKA “Jehona e malësisë”, Ansambli Dibra. SHKA “Andrini” SHK “Ardhmëria” Gjakovë dhe natyrisht Grupi Folklorik “Petralba”, Bashkia Klos

Ky festival ngjasonte me një basen të gjerë me ujë kristaltë të ushqyer nga shumë burime dhe kroje të dëlira të botës shqiptare.

Gjeja më pozitive ishte, se secili grup u prezantua direkt (live), duke i dhënë gjallëri emocion dhe vlerë veprimtarisë pasi kënga kështu ka rrjedhur gjithmonë nga buza e rapsodëve nder shekuj. Secili grup, secili ansambël, secili rapsod shpalosën me seriozitet dhe në nivel, kostumografin e pasthirmën trevës nga buronin, vargun, instrumentin karakteristik vallet dhe këngët e litologjisë burimore duke shpalosur sythet e të flokut, që buron nga zemra e popullit. Përveç vlerave të njohura të pasurisë folklorike burimore të trashëguar brez pas brezi, në skenë u pasqyruan dëshmi të qarta të identitetit etnik shqiptar.

ÇFARË SOLLËN NË SKENËN E KLOSTIT 14 GRUPET E ANSAMBLEVE KONKURSE?

Më së pari në skenë u ngjiten, jashtë konkurrimit, të zotët e shtëpisë, artistët e Grupit Folklorik “Petralba”, me valle karakteristike brezash, kërcyer nga Pëllumb Elezi, Rexhep Ahmati, Emiljano Elezi, Denis Ahmati, shoqëruan me ciganë Adhurim e Sokol Xhepi dhe në lodër Man Xhepi; melodi karakteristike me çifteli, interpretuar nga Ikli Punavija; këngën “Krah për krah luftoi me burrin”, kushtuar heroinës Shote Galica, kënduar nga Veri Beça dhe vallen me motive të Xibrit, kërcyer nga valltaret e reja, Xibër. “Valon i lirë flamuri kombëtar”, të cilën e interpretuan Fatmir Berisha e Xhavit Maxharra. Konkurrimin Grupi Folklorik “Gurra e

kënduar nga Agim Huna, shoqëruar në çifteli nga Besnik Dema, Bujar Lika, Rrahim Alliu, këngën për shah Fejzë Bulqizën; melodi instrumentale me çifteli nga Besnik Dema, si dhe valle burrash, kërcyer nga Sinan Alliu e Bujar Çupi. Këngëtarët Nazmi Hajdari dhe Afrim Krasniqi, nga jugu i Kosovës, komuna Ferizaj, u mirëpritën për interpretimin e këngës “Seç na erdh kjo ditë eksodi”. Nga fisi historik i Shoshit, malësia e Dukagjinit, Shoqëria Kulturore “Besa Shosh” kishte këngë majëkrahut, akapëlo, kënduar nga Gjon Kosteri e Gjesh Kola; vaje me lahutë, luajtur nga Gjon Kosteri; Balada Shalë – Shosh - Mirditë me çifteli, e kënduar nga Gjesh Kola “Nat e dit lotoj prej madhit” e kënduar nga Kolë Martin Aramadhi dhe putira (këngë burrash), interpretuar nga grupi.

Në skenën e Klosit ata interpretuan potpuri këngësh me melos të Tetovës. “I dhe kombit të parin mbret”, ishte kënga popullore folklorike për Matin, të cilën e interpretoi këngëdari dibran, Bledar Kaca, i Ansambli Folklorik “Dibra”, Peshkopi. Dhe për të mbyllur konkurrimin, artistët e komunës së Rahovecit, të Shoqërisë Kulturore Artistike “Anadrini”, interpretuan këngët “Larg teje, o nënë”, nga Vlora Duraku, “Kreshtat e Kosovës” nga Islam Morina dhe suitë orkestrale të Baki Xhaferrit, shoqëruar nga orkestra. Me pjesë folklorike u ngjiten në skenë për të përshëndetur festivalin vajzat e shkollës 9-vjeçare Gurrë e Vogël me valle vendçe grash të zonës së Gurrës; këngëdari Halil Aliaj, i Grupit Folklorik “Gurra e Kurbinit” Kurbin, me këngët “Jo gjakmarrje, por pajtim” dhe “Veç bashkimi



Kurbinit”, Kurbin, i cili solli në skenë këngët “Lum kjo ditë që sjell Nëntori”, kënduar nga grupi i burrave; “Trázmzit e beqarit”, nga Terezina Gega dhe “Kërkon qyqja mal mbi mal”, kënduar nga Mide Aliu.

Nga rrafshi i Dukagjinit, si buqetë bjeshke Grupi Folklorik i Istogut, erdhi me këngën e Selman Kadrisë, kënduar nga Ismet Demaj; vallen dyshe të Podgurit, kërcyer nga Sadik Manxharaj (baca) dhe Ismet Demaj, si dhe melodinë me daulle e zyrlë, interpretuar nga Faton Bytyçi dhe Ukë Kamberaj. Këngëtarët kuksiane Selvije Hajdini Sylaj dhe Beglie Ahmetaj kënduan “Mirë se të gjej, i bukuri Klos”, potpuri dasme kuksiane dhe “Një këngë të re këndoj me çifteli”. Qendra Kulturore Bulqizë, e Qarkut Dibër, solli në skenë këngë vajkalore,

Vazhdoi konkurrimit Shoqëria Kulturore Artistike “Zëri i Llapushës” Carallukë, nga Malisheva.

Në program kishte valle burimore me çifteli, interpretuar nga grupi i instrumentistëve; melodi baritore me fyell nga Jakup Krasniqi, këngët “Dola me shëtit në baçe”, kënduar nga Erestinë Hoti dhe Doruntinë Zogaj, “S’kam kujtue kurrë për jetë”, kënduar nga motrat Kaltrinë e Festinë Gashi, “Ditët po kalojnë”, nga Elita Krasniqi dhe valle tradicionale e Llapushës, kërcyer nga grupi i vajzave.

Në shumë skena shqiptare janë ngjitur dhe kanë interpretuar folklor me këngë e valle shqipe, Hajri Ismani, Xhemal Abdylrahmani e Dashmir Saiti, artistë të Shoqërisë Kulturore Artistike “Jehona e malësisë” Tetovë, kanë mahnitur publikun.

forca e kombit”, si dhe këngëdari matjan, Shkëlqim Farrici, me këngët kushtuar Sali Vatdodës e “N’kamë e tan’ Kosova”.

SHKA “ZËRI I LLAPUSHËS”, MALISHEVË FITUES I ÇMIMIT TË PARË, “FEST FOLK KLOSI -2019”

Konkurrimet u ndoqën nga publiku me mjaft interes, grupet konkurruese pati këngë, valle, rite e melodi, të cilat u interpretuan me elegancë nga bartësit e folkut shqiptar, sepse sollën vlera të shumta në drejtim të promovimit të trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare.

Në krye të jurisë ishte Ali Mulaj, “Mjeshtër i Madh”, Sipas tij, “Fest-Folk Klosi” 2019 është nga veprimtaritë kulturore dhe artistike më të mira, që bashkia e Klosit organizoi për të promovuar

sa më shumë të jetë e mundur vlera folklorike. Festivali ishte dëshmi e një realitet të ri folklorik, pasi u pa konkurrimi i grupeve nga krahina të ndryshme të nacionalitetit. Si juri e besuar, e fushës së etnomuzikologjisë, etnografisë dhe kostumeve popullore, për grupet më të mira konkurruese të festivalit dhe për interpretuesit më të mirë individualë u dhanë vlerësime.

Çmim të tretë morën rapsodët nga Ferizaj, Nazmi Hajdari e Afrim Krasniqi dhe SHKA "Anadrini" Rahovec; çmim të dytë "Jehona e Malësisë" Tetovë dhe «Besa Shosh» Dukagjin, ndërsa çmimin e parë e fitoi SHKA "Zëri i Llapushës", Malishevë.

Sipas vlerësimit të Jurisë, Rapsodi më i mirë i festivalit ishte Gjon Kosteri nga SHKA "Besa Shosh" Dukagjin; instrumentisti më i mirë Baki Xhaferi, SHKA "Anadrini" Rahovec; Vallja më e mirë ishte Sinan Alliu, Bulqizë; Valltarja më e mirë Floranda Bytyçi, SHKA "Zëri i Llapushës" Malishevë; Orkestrina më e mirë e festivalit SHKA "Anadrini" Rahovec; Kostumi autokton i festivalit ishte i Grupit Folklorik, Kurbin.

Ndonëse konkurrenca ishte e madhe, ngaqë pjesëmarrësit vinin nga troje të ndryshme etnike shqiptare, SHKA "Zëri i Llapushës" Carallukë bëri diferencën duke u vlerësuar më e kompletuara e festivalit. Ndërsa për vlera të trashëgimisë së pashtershme folklorike dhe interpretim me nivel të lartë artistik, u dhanë çmimi i publikut për Grupin Folklorik nga Kukësi dhe Çmimi i karrierës për Fatmir Berishën, Gjergj Lekën, Nazmi Hajdarin, Gjon Kosterin, Ismet Demajn, Baki Xhaferrin dhe Agustin Cekën, me motivacion: "Për kontribut shumëvjeçar, nivel të lartë e mjeshtëri artistike në interpretimin e folklorit burimor tradicional ndër vite".

Për ruajtjen e trashëgimisë folklorike të trevës së Klosit, kryetari i Grupit Folklorik "Petralba", Ikli Punavija, vlerësoi me mirënjohje valltarin Murat Murati (pas vdekjes), instrumentistin Mehmet Kurti, rapsodin Nezir Neli (pas vdekjes), instrumentistët Veri Koburja e Shaban Ferra, instrumentistin Hasan Ferra (pas vdekjes), valltarët Nazmie Hoxha e Isuf Topalli, si dhe ish-përgjegjëset e kulturës Avni Halili e Sali Shqypi.

Organizatorëve të festivalit u afruan mbështetje financiare "Koka & Ergi Energy Stavëç", "Alb Lea Internacional", Studio "Hasa", "Gjoka Konstruksion", "Ndregjoni", "G. P. G Company", "S. B. M Grup", "Redi Mat", Valbona Kola, Ilmi Hoxha, Asllan Muharremi, si dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Tiranë.

Fest Folk Klosi" 2019 ishte tervesa e madhe e flokut burimor cilësia dhe zgjerimi i gjeografisë së grupeve pjesëmarrëse, duhet të vijoj edhe më tej në ardhmen duke synuar prurjen e vlerave folklorike dhe artistë popullorë nga më shumë treva shqiptare. Festivalit i dhanë kolorit dhe emocion prezantuesit elokuent dhe simpatik Meti Kurti dhe Anxhela Rama

Pas fotografisë tradicionale me fituesit e çmimeve folklorike, u organizua një drekë e bujare e përbashkët, ku nuk munguan çaste të bukura argëtimi. Gjithë konkurrimet e shoqërive kulturore artis-

tike dhe grupeve folklorike në këtë skenë përbëjnë në vetvete një histori të dytë suksesit të këtij manifesti ku pa dyshim merita kryesore u përket Drejtorit të festivalit Z. Ikli. Punavija Udhëheqësit artistik Z. Ferit. Hoxha Ky festival solli mesazhin e qartë, se folklori kalon nga brezi në brez dhe kjo traditë duhet vazhduar ndër breza

në disa veprimtari në Shosh, Shkodër Klinë, dhe pa dyshim më i rëndësishmi ishte Fest Flok Klosi" 2019, ku për arsye objektive pjesëmarrja e grupit nuk ishte i plotë. Gjon Kosteri, Kolë Martin Aramadhi, Ndoc Fusha dhe Gjëlosh Kola shkuan, pa pompozitet, pa pretendime për trofe, por ishte dëshira, vullneti dhe pa-

në skenën e Klosit si jehonë e largët e baladave të lashta Ilirio-Arbërore. Ajo u paraqit ashtu siç është kënga e pare kur shkelë, nusja në prag kur mbudheshin miqësia në konak, por edhe në çdo tribunë folku burimor dukagjinas

Ka bjen dredhi ka bjen hana / Princ si Lekën nuk ban nana.

Gjon. Kosteri dhe Gjëlosh. Kola për herë të parë në një skenë mbarë nacionale, por në mes shoshianve e dukagjinave të Matit dhe të Rrafshit të Dukagjinit i kënduan princit arbërore më karizmatik dhe më të shumë përfolur Lekë Dukagjini

Prurja e dytë, lahuta simfonia shekullore e malësorit tonë të dënuar e fatlum të jetojë mes maleve të larta, për ruajtjen e tharmit të racës sonë të vjetër Ernest Koliqi pat shkruar: -Kur shkova në Dukagjin Aty dëgjova këngët më të pastra që mund të derdhën nga buza e shqiptarit. Elegjia "Qan motra të vëllamë, qe një pritje me dinjitet, që interpretuesit Gjon Kosteri ju dha çmimin e parë. Ky prezantim është edhe një tërheqje vëmendje ndaj rapsodëve të tjerë dukagjinas, që të mos e nënvlehtësojnë sharkun e vjetër pasi ajo peshon shumë rëndë në skenat e folklorit dhe vlen shumë tepër se qindra e qindra lule -lajle hibride të turbo flokut.

Prurja e tretë e shumë duartrokitur, ishin Putirat motit ose këngët gazmore të rakisë. U sollën bukur, thjeshtë, me përmbajtje dhe alegri artistike ishin krejt të veçantë dhe u pëlqyen nga gjithkush i pa dhe i dëgjoi.

Mua ka kohë që më shqetëson fakti i mos përfilljes, që u është bërë po thuaj në të gjitha paradat e përvitshme të flokut dukagjinas, ndërkohë që duhej kishin vendin e tyre që meritojnë si poezi e improvizuar dhe kënduar gazmore tipike dukagjinase.

Balada e Shalë-Shosh-Mirditë u këndua shumë lirshëm me një zë të kadihtë nga Gjëlosh Kola dhe u mirëprit pasi përfaqëson një legjendë të vjetër të njohur dhe kthyer si kult në një trevë të gjerë, që është Gegnia.

Këngëtarët e shumë talentuar dukagjinas vërej që po rendin pas rapsodive epike të "heronjve të heshtur".

Këshilla ime është të kthehen tek baladat që për fat Dukagjinit nuk i mungojnë.

"Natë e ditë lotoj prej madhit" ishte një lirikë kënduar në mënyrën më të ndjeshme pa asnjë sforcim nga zëri melodioz i jaranit të vjetër të flokut, Kolë Martin Aramadhi.

Instrumentisti Ndoc Fusha ishte në lartësinë e më të mirëve të kësaj veprimtarie qoftë në skenë qoftë jashtë skene, duke inkuadruar në mënyrë intuitave dhe të menjëhershme më shumë mjeshtër të odave kosovare e tetovare.

Urime Grupit "Besa" të Shoshit, që përçoj me dinjitet një strajcë nga folku dukagjinas, në festivalin nacional "Fest Folk Klosi - 2019".

Një urim mirënjohës për gjithë grupin organizatorë dhe mënyrë veçantë për Zj. Aishe Kodra, për shoqërimin, mirësjelljen dhe pritjen bujare që i rezervuan grupit tonë.

Prelë Milani,
Klos, me 13. 10. 2019



e motet në vijim.

GRUPI FOLKLORIK "BESA E SHOSHIT" NDEROHET ME ÇMIMIN E DYTË DHE RAPSODI MË I MIRË GJON KOSTERI NË EDICIONIT E DYTË "FEST-FOLK KLOSI 2019

Është një grup i ri i krijuar pak më shumë se një vit më parë me këngëtarë dhe instrumentist me përvojë dhe të afirmuar prej shumë vitesh në bunet e flokut dukagjinas si Kolë Gjoni, Gjon Kosteri Gjovalin Shani, Kolë Aramadhi, Gegë Zefi, Ndoc Fusha, Gjëlosh Kola, Bardhok Lami, Zef Temeli, Vat Aramadhi e të tjerë.

Ky grup ka nisur veprimtarinë e tij,

sioni, që të pasqyronin diçka specifike nga folku dukagjinas. Ata ishin ndoshta grupi më i ri ndër 14 skuadrat përfaqësuese me gjeografi të gjerë nacionale dhe përvoja në sa e sa festivale.

Isha me ta, në skenë vetëm si figurant, i ndoqa me shumë emocion dhe më benë të ndihesha krenarë që isha në mesin e tyre. Duke pare reagimin e publikut dhe jurisë që gjendej në reshtin e pare te tribunës ju thash: -Parandiej se nuk do të ndaheni pa çmim dhe ashtu ndodhi. Grupi fitoi çmimin e dytë të festivalit por dhe çmimin Rapsodi më i mirë i festivalit që unanimisht ju dha Gjon Kosterit.

Suksesi ishte se, në pese interpretime virtuozë, tre ishin të veçantë nga gjithë grupet e tjera Kënga e majëkrahut (akapelo) tipike Dukagjinase erdhi



FESTA NACIONALLE E AUSTRISË

Tani u bë traditë, që çdo vit në Shkodër, nën drejtimin zotit Gjergj Leqjeza, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë, të mbledhemi në mjediset e Hotel "Rozafa" të festojmë Festën Kombëtare të Austrisë.

Pra, edhe këtë vit, si përhera, me datën 22 tetor 2019, u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit në Shkodër, i Republikës së Austrisë, zoti Gjergj Leqjeza dhe zonja Natalia Leqjeza, bashkë me të ngarkuarin me punë të Ambasadës së republikës së Austrisë, zotin Christian Steiner në Tiranë.

Morën pjesë deputet, përfaqësues të autoriteteve vendore të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër, personalitete në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e sociale të bashkisë tonë. Morën pjesë dhe përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, Agron Hasanaj, Anton Kosteri e Syka Çarku. Pasi, u ekzekutuan Himni i Republikës së Austrisë dhe i Republikës së Shqipërisë, fjalën e rastit e mbajti, Konsulli i Nderit, Gjergj Leqjeza.

Pastaj të pranishmit i përshëndeti i ngarkuari me punë të Ambasadës së republikës së Austrisë, zoti Christian Steiner, në Tiranë

Në fund të përshëndetjeve u dha një koketejl për pjesëmarrësit dhe vijoi festa në grupe-grupe.

Fjala e rastit e zoti Gjergj Leqjeza, Konsulli i Nderit i republikës së Austrisë, në qytetin e Shkodrës

Të nderuar përfaqësues të komu-

niteteve fetare,

Të nderuar drejtues të pushtetit vendor,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

I nderuar i ngarkuar me Punë i Ambasadës Austrisë, Zoti Steiner,

Të nderuar miq,

Dëshiroj t'ju falënderoj për zemërsisht për pjesëmarrjen në Festën Nacionale të Austrisë dhe gjithashtu t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj të vijueshme, që në vitin e parë të hapjes së Konsullatës së Nderit .

Jemi mbledhë këtu për të festuar Festën Nacionale të Austrisë, popullit mik Austriak simbol i kulturës , mirëqenies e paqes në Evropë e më gjerë, e cila padyshim bëhet edhe më e bukur me prezencën tuaj sot ...

Faleminderit !

Festojmë Festën Nacionale të Austrisë

mbas një viti të mbushur me veprimtari në kuadrin e "Vitet të kulturës Austriako-Shqiptar", në të cilin u përfshinë të gjitha fushat e jetës dhe pothuajse gjithë territori i Republikës së Shqipërisë ku Shkodra zë dhe vendin kryesor si qendër e Metropolit të Veriut.

Kjo është fryma që sjell Austria në Shkodër dhe unë jam krenar që të përfaqësoj një komb me kaq shumë dimensione kulture, zhvillimi dhe humanizmi dhe jam po aq krenar që lidhjet mes nacionaliteteve tona, po forcohen dita ditës dhe që Austria me drejtuesit e saj kanë qënë e vijnë të jenë përkrahës e garantë në rrugën pa kthim të Shqipërisë në familjen evropiane.

Sivjet ishte dhe fundi i misionit diplomatik në Shqipëri i ambasadorit Steiner dhe një fillim i ri në karrierën e Zotit

Christian Steiner, sot si i ngarkuar me punë i Ambasadës, por si Ambasadori i Austrisë në Shqipëri mbas disa ditësh, të cilit personalisht dhe nëse më lejoni dhe në emrin tuaj ti urojmë: Sukseset e mbarësi në detyrën e Tij, si Ambasador në Shqipëri.

Sivjet festën tonë besoj do ta bëjnë më të bukur orkestra e harqeve e Sigal Uniqa Shqipëri, të cilën dëshiroj ta falënderoj për prezencën dhe kontributin për këtë mbrëmje.

Edhe një herë shumë faleminderit për prezencën e tyre

Gëzuar Festën Nacionale të Austrisë!
Faleminderit!

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"



MIGJENI “RIKTHEHET” MES NESH

Sot përjetova, personalisht, një ditë mjaft mbresëlënëse, si një zë modest i letrave shqipe, veçmas si studiues i Migjenit.

Në këtë 12 tetor 2019, në ora 10. 00, Shkodra përcolli një ditë të veçantë, që do ta quaja: “Një hap i Shkodres drejt vet-vetes”.

12 TETORI 2019, një ditë përpara lindjes së MIGJENIT, ndryshe në 108 vjetorin e lindjes së poetit tonë të madh, prej së cilës brezi i ri, që lind e rritet, sidomos, në Shkodër, do të mësojë ku banoi poeti ynë i përmasave evropiane, poeti ynë pa paraardhës dhe pa pasardhës, siç shprehet eruditi dr. Moikom Zeqo, poeti që u kryqëzua, si dikur Fishta e Mjeda, nga verbëria parapolitike provinciale, do të mësojë shtëpinë ku banoi poeti.

Aq e shtrenjtë qe ajo shtëpi për brezin tonë, por, mjerisht, pas viteve “90, me një status të humbur në stinën e mbrapshtisë sonë demokratike, që përfundimisht mbeti prapa si një kujtim po aq i mbrapshtë për ideatorët dhe viktimat e struktura të saj si skllëvër të neoideologjisë në epokën e postideologjisë.

Kjo ditë e madhe erdhi jo rastësisht, por falë sqimës progresiste, elitare të Dom Nikë Ukgjinit, personalitet i njohur si klerik dhe si studiues skrupuloz, i cili në bashkëpunim me z. Gjergj Leqejza, konsull nderi i Austrisë në Shkodër, si dhe me motrat françeskane, që pranuan vendosjen e pllakatit në banesën pronë e tyre, ish-shtëpia e poetit, solli mes nesh adresën më interesante në epokën e individiumit dhe të postskemave, “Shtëpia ku banoi Migjeni”.

Një takim, krejt modest, pa bujë, një takim gjithë thelb, edhe pse nën turrin e një indiference mjerane kulturore, bashkoi miqtë e Migjenit, duke u dhënë zemër të ndihen më të lirë, brenda vetes, edhe atyre që, mjerisht, nuk i dhanë vetes zemër të vinin deri aty:

Një paradoks, veçanarisht, për ata që guxojnë t’i thonë vetes “krijues”, intelektual, studiues apo civil. Pllakatit e zbuloi z. Gjergj Leqejza, konsull nderi i Austrisë në Shkodër, i shoqëruar nga prof. dr. Alfred Çapaliku, pedagog në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Në fjalën e tyre përshëndetëse, me fjalët më të gjetura, zotërinjtë: prof. dr. A. Çapaliku, Gjergj Leqejza, Dom Nikë Ukgjini, Zija Vukaj, kryetar i shoqatës së shkrimtarëve, Shkodër e të tjerë shprehen atë që, secili ndjente brenda vetvetes, për poetin e madh, të epokës së postdogmave, si poet elitare i postmodernitetit, në kontinentin evropian, për të cilin, jo thjesht njihen mbi 200 tituj librash të shkruara, por njëherësh ai është edhe poeti ynë, më i përkthyeri në botë, pas KADARESE.

Këtij evenimentit ia ridimensionuan vlerat edhe interpretimet elegante të pjesëve nga krijimtaria e Migjenit nga ana e dy aktorëve të mirënjohur të Teatrit “Migjeni”, Agron Dizdari dhe Merita Smaja.

Gjithçka u realizua në prani të medieve, krejt e thjeshtë në dukje, por me vlerë të jashtëzakonshme në thelbin e



Konsulli i nderit të Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqejza dhe profesor doktor Alfred Capaliku,



Profesor doktor Alfred Çapaliku në fjalën e rtastit

saj, kur kujtojmë atë që e tha, aq sinqerisht, si një gjetje dinjiteti, kryeshkrimtari dhe përkthyesi i talentuar z. Zija Vukaj: “Një ditë kur kishim humbur çdo shpresë se Migjeni do të “rikthehej” ndonjëherë mes nesh”.

Po, ja që “Migjeni nuk na harroi” me domosdoshmërinë e nevojës për ta pasur në gjirin tonë, veprën e tij, si sfida më serioze ndaj “zotërve” të kohës sonë, ndryshe SI KORIFEU I KOHËS SE NJERIUT.

Në fund për të pranishmit nga organizatorët u shtrua edhe një koktej.

Kadri Ujkaj,

Kryetar i shoqatës “Shkrimtarët dhe Artistët”, Malësi e Madhe



MULLINJTE E ERËS SË DON KISHOTËVE SHQIPTARË!

Këto ditë po shihja intervistën e fundit të dhënë për një media Shqiptare të Mbretëreshës Geraldine të Shqipërisë, edhe dëshira e saj më e madhe ishte të ndërronte jetë në Shqipëri. Fatmirësisht 4 muajt e fundit të jetës së saj i kaloi në Shqipëri, të mendosh se kjo dëshirë kaq e zjarrtë nuk ishte nga një Shqiptare, por ajo shprehet se ajo ishte mbretëreshë e Shqiptarëve dhe ju përket atyre, na përket neve dhe e tillë ndihej.

Kjo situatë vjen në një moment kur çdo i ri Shqiptar nuk ka një ëndërr për të ardhmen, por dëshira e vetme është të largohet nga Shqipëria. Nëse pyet një gjimnazist çfarë dëshiron të bëhesh, të përgjigjet, të mbaroj shkollën dhe të iki nga Shqipëria.

E vërteta është se në çdo periudhe historike të saj Shqipëria ka pasur largime, por jo vetëm, në çdo periudhe të caktuar të historisë së saj ka eksode për arsye të ndryshme, por kryesisht ekonomike. Disa shqiptarë të larguar që kanë krijuar një pasuri të caktuar ekonomike janë kthyer dhe investuar në vend, por shumica prej tyre vijnë në lulezime akoma në vende të ndryshme dhe shumë prej tyre janë edhe të suksesshëm ndërnacionale. Po sikur këto investime të ishin të gjitha në Shqipëri? Si do të ishte Shqipëria?

Disa prej shqiptarëve të larguar janë kthyer dhe investuar si në biznesin e agroturizmit apo ndonjë prej tyre edhe duke mbajtur emrat e metropoleve të mëdha



botërore dhe jemi dëshmitare se shumë prej tyre janë janë të suksesshëm. Pothuajse shumica në fushën e hotelierisë dhe restoranteve dhe është pozitiv fakti se gjithsesi këta shqiptarë janë kthyer për vendin e tyre. Nëse bëjmë një përmbledhje nga Veriu dhe zbrësim më në jug e vëmë re se rritet shumica e investimeve bie duke e bërë zonën e maleve të veriut zonën më të "varfër" për sa i përket investimeve, përjashtuar këtu fshati i Thehthit, duke e lënë komplet të shkrete nga njerëzit dhe zhvillimi fshatrat e krahinat rurale të vendit ndryshe nga vendet e tjera që këto zona mbajnë burimet më të forta të të resurseve natyrore dhe ne ende nuk ka infrastrukture në këto zona.

Por, megjithatë se ka pasur investime

në vendin tonë nga të gjithë ata që kanë vendosur të kthen përsëri shumica dërrmuese vendosin të qëndrojnë atje, ku tashmë kanë krijuar jetën e tyre atje dhe këtu ne mund të përmirësoheni si në fushën e investimeve edhe ne fushën rritjes së numrit të tyre, të gjithë që vinë duan të investojmë në bar ose restorant dhe pothuajse asnjë nuk ka sjelle ndonjë ide për zhvillimi dhe emancipimin e përgjithshëm të zonës, për të gjithë rrisin atë titullin që i kemi vendosur vetes "shoqëri e kafeve", por në fund të fundit ngushëllohen me faktin se vetëm ky biznes ecën në Shqipëri ku secili prej nesh akuzon shoqërinë, por secili prej tyre ideja e pare e biznesit që mendojnë me hap është bar e luftojmë me mullinj erës si Don Kishoti.

Në fakt idetë janë plot dhe shumë të bukura që nga bizneset sociale e deri ato që realisht emancipojnë zonën rurale dhe malet e Dukagjinit dhe Malësisë.

Mund të fokusohemi siç përmenda me lartë në zhvillimin e përgjithshëm afatgjatë të zonës dhe një nga pikat tona më të forta dhe fatmirësisht po vihet re nga të huajt është turizmi dhe në këtë fushë të investojnë diaspora shqiptare, por një ide mund të ishte edhe mullinj të erës, si në fshatrat e Gjermanisë janë plot me mullinj ere, ose ideja do të ishte edhe të përdornim burimet ujore për të pasur një birra me emrin e maleve të Dukagjinit, fqinja jonë më e afërt Kosova e ka, dhe një pistë mund të ishte një ide gjeniale që do rriste shumë të ardhurat e zonës.

Nëse shikojmë edhe në mbrojtje të mjedisit janë të gjitha biologjike që e mbrojnë pse jo edhe një biznes riciklimi që për hir të së vërtetës na mungojnë në Shqipëri pasi ende nuk e kemi kulturën e produkteve të riciklusehme.

Le të jetë kjo ide për një pikënisje të një studimi, vlerësimi pse jo në afatgjatë ose afatshkurtër për emancipim real të shoqërisë dhe vendit ne termat të numërueshëm, reale dhe jo vetëm imagjinare fiks si mullinj e ushtarët e Don Kishotit, se ne e dimë se luftën më të madhe e kemi me veten në fillim.

Klodjana Serraj

U NDA NGA JETA, GJINI LULASHI

Urtësia popullore na mëson, se kur ka një jetë tërësisht me vlera e virtyte, bartësi i tyre duhet vlerësuar e nderuar!

E tilla ishte jeta e bashkëfshatarit tim të dashur, Gjini Lulashi, e cila u mbyll para disa ditësh, duke lënë në pikëllim të thelle bashkëshorten Paskualina, djalin Gjergjin, vajzën Ema si dhe vëllain Dedën, motrat Zoje,

Mira e Tone, pjesëtarët të tjerë të atij trualli, ku lindi e u rrit Gjini, 66 vite më parë.

Gjini lindi në vitin 1953, në fshatin Lotaj të krahinës së Shalës, nga dy prindërit e tij të mirë, të urtë, të ndershëm e fisnike, Mushak e Sose Deda.

Ai lindi në një truall me tradita të shquara atdhetare e patriotike, nderi e burrërie, n' atë truall ku lindi gjyshi i tij, Dede Lulashi, bashkëluftëtar i legjendarit Mehmet (Sokol) Shpendi, pjese e rreshtimit të "Djemnisë së Shalës", njeri trim, i ndershëm e besnik, i zgjedhur si pjesëtar i ndenje, përfaqësues i Shalës në takimin me Krajlin e Malit të Zi, krahas



burrave të tjerë të shquar Mehmet Shpendi, Çun Nika e Marash Delia, të cilët u torturuan, u keqtrajtuat dhe më në fund, pabesisht u pushkatuan, në Nderkiza të Planit, me 15 korrik 1915

Deda si më i riu, i zgjuar, i shkathtë e trim u zgjodh për të çuar kushtimin në Shalë. Ishte zgjuarsia e Dedës, që e pa dhe e kuptoi domethënien e lëvizjes

së gishtit të këmbëzës nga Mehmeti, me duar në pranga, prandaj ai me dhimbje të thelle e lot në sy, që po i linte shokët para vdekjes se si e quante veten, por fluturoi në Shalë për të çuar në vend amanetin e Mehmetit, që ajo të mos mashtrohet e të mos dorëzojë armët dhe të kapi qafat për të mbrojtur deri në fund vatanin.

Edhe djemtë e Dedës e sidomos më i vogëli i tyre, Muashaku ecën në gjurmët e babës si luftëtar të lirisë. Ai mori pjesë aktive në Luftën Nacional Çlirimtare, fillimisht në çetën partizane të Dukagjinit dhe më vonë në batalionin "Perlat Rexhepi" bashkë me shokët e tij Mark Pjetra e

Martin Gjoni duke luftuar me trimëri deri në çlirimin e plotë të Atdheut.

Në vatrën e tij familjare, Gjini u lind e u rrit, me një edukate të shëndoshe morale e shoqërore, me një dashuri të thellë për Atdheun, me etjen për dije, për urti, thjeshtësi e dashuri, për njerëzit, për tu shërbyer atyre me përkushtim me punë të ndershme, me aftësi e kompetencë.

Gjini pasi shkollën fillore, shtatëvjeçare e të mesme, shkollimin e lartë e mori në profilin ushtarak, duke u kompletuar, me cilësi e virtyte të larta dhe me dije e aftësi profesionale, si mjeshtër në profilin e tij, kurdoherë në shërbim të atdheut.

Tek Gjini, bashkëpunëtorët, shokët, eprorët, por sidomos vartësit e tij, në shërbimet speciale e delikate, kanë parë njeriun e ditur, të aftë, të thjeshtë, të ndershëm, të besës, të fjalës, të durueshëm e gjakftohtë, këmbëngulës për të çuar deri në fund e me faqe të bardhë në detyrën e tij deri sa doli në lirim.

Gjini si një tip i veçantë, i vëmendshëm e i përbajtur nuk mburrej për të kaluarën e tij apo për punën e tij në marrëdhënie me të tjerët. Ai nuk bërtiste, nuk hallakatej, të dëgjonte me kujdes, të sqar-

ronte me durim pa cënuar dinjitetin e as personalitetin e askujt dhe sidomos e vartësive e shokëve të tij, të punës. Ishte kjo arsyeja, që ai gëzonte respekt e dashuri.

I tillë, qe edhe në jetën familjare si bashkëshort, si baba, si vëlla e mirënjohës për të gjithë, për të afërmit, shokët, për miqtë e shumë të kishte ai.

Fatqëqësisht një njeri, me të tilla vlera e virtyte të spikatura e rrëmbu vdekja, pas një sëmundje të rëndë e të gjatë edhe pse u bë gjithçka e mundur për te në vend dhe sidomos nga mjekësia italiane. Ai luftoi me te deri në fund edhe pse nuk ia doli, ai tregoi karakter të fortë, durim dhe kuraja për të mos u ligështuar sidomos para bashkëshortës e vajzës, të cilat i qëndruan te koka gjatë gjithë kohës.

Përcjellja për në banesën e fundit, pjesëmarrja ishte masive.

Me dhimbje e lot në sy familjarët, të afërmit, shokë e miq të shumë nga fshati e qyteti i dhanë lamtumirën e fundit, me bindjen se ai dhe kujtimi i tij do të mbeten gjatë në zemrat tona.

Kur ikën një jete njeriu na dhembë të gjithëve, por kur ikën një njeri me vlera si Gjini, me emër të mirë, u dhembë edhe zogjve të malit.

Gjini ynë, i lehtë të qoftë dheu i Shkodrës!

Ndoc Grimaj

MASAKRA E XHANIT NË 75 - VJETORIN E KUJTESËS!

Në prag të 75 vjetorit të masakrës të terrorit komunist të 10 malësoreve nga fshati Khan, Dajcë e Shosh, në Qafë Thanë të Bruçajve u vendos memorial i kujtesës me emrat e të pushkatuarve, sot dëshmor të demokracisë.

Në çdo kohë kush ka luftuar kundër pushtuesve të huaj, janë yje të pushuar në altarin e Atdheut e të Kombit shqiptar përfshi dhe dëshmorët e luftës nacional – çlirimtare. Këta të fundit duhet pastruar nga krimet dhe kriminelët vëlla-vrasës që bënë në emër të luftës kundër reaksionit për të garantuar pushtetin e vetëm komunist të pas çlirimit.

Me luftën nacional-çlirimtare nuk duhet abuzuar e nuk mund të justifikohen veprimet e komandantëve e të komisarëve urdhër dhënës ose njerëzit besnik të Partisë Komuniste të pajisur me kartabiankë në dhunimin e pushkatimit pa faj e pa gjyq të njerëzve e të popullit të pafajshëm sidomos të burrave në zë.

Mbështetësit dhe inspiruesit në krimet e bëra vëlla-vrasëse ishin:

Partia komuniste me Enverin dhe misionaret e Partisë Komuniste Jugosllave, Miladin Popoviçi, Dushan Mugoshoi, Bllazha Jovanoviç, Velimir Stojniçio, e të tjerë. Në Nëntor 1944 Enver Hoxha firmosi urdhrin për brigadën e 6-të partizane të ndërmerre operacionin për shpartallimin e forcave reaksionare në Dukagjin.

Dukagjini nuk ishte i pushtuar as nuk kishte asnjë ushtar të huaj nazifashist.

Po për të cilat forca reaksionare bënte fjalë Enver Hoxha!

Po, kur fliste për forcat reaksionare kishte parasysh:

Dukagjini ishte kryeqendra e katolicizmit shqiptar nder shekuj dhe nuk pajtohej me bolshevizmin e komunizmin.

Kishte parasysh se fretaria ishte me kulturë të gjerë arsimore e fetare e njihnin shumë mirë çfarë ishte bolshevizmi dhe komunizmi, ai frikësohej se këtë do ta bënin të ditur popullit besimtar se ata luftonin fenë, kishat, xhamiat, klerin dhe besimtarët.

Burrat e njohur e të respektuar i konsideronte një pengesë plus ne instalimin e komunizmit e të sistemit social-komunist.

Këta tre faktor Enver Hoxha i quante forca reaksionare që duhej shpartalluar me dhunë terror dhe pushkatime pa gjyq, siç edhe bëri defakto. Ndaj këtyre e Dukagjinit në përgjithësi Enveri kishte fobi të pa përballueshme. Dukagjini nuk kishte grupe as formacione të organizuara kundër luftës nacional-çlirimtare as kundër formacioneve partizane. Në Dukagjin nuk kishte ballist, zogist as kuisling të organizuar. Në Dukagjini kishte nacionalist patriot edhe këto jo të organizuar kundër partizanëve as njësie partizane.

Në të gjithë hapësirën e Dukagjinit nuk është luftuar as nuk ju kanë zënë prita qoftë edhe të një partizani të vetëm, as

nuk është vrarë asnjë partizan me përjash-tim të Çelo Sinanit, që u vra në Stenë të Bruçajve në mbrëmjen e 26 nëntori 1944, ku shkaktarë ishte vetë Çelua. Dukagjini ndaj luftës nacional-çlirimtare ka mbajtur qëndrim indiferent, bëhej luftë bolshevike që nuk kishte asnjë të përbashkët me lirinë e demokracinë e vërtet, në programin e saj kishte përmbajtje ateiste, kundër fesë e klerit në përgjithësi e atij katolik në veçanti, ata deklarorin se bolshevizmi e komunizmi nuk njohin fenë as Zotin, kishat as xhamiat. Kjo kishte edhe një arsye më tepër që Dukagjini qëndroj indiferent ndaj luftës, por as nuk e kundërshtoj më armë. Kjo ishte arsyeja tjetër që forcat partizane të brigadës 6-të të shfrynin gjithë dufin e terrorit mbi popullin, klerin katolik e mbi burrat e ndërruar të Dukagjinit pa bërë asnjë faj me akuzë absurde për armë-mbajtje duke shkaktuar dhimbje të madhe, duke lenë nëna e motra të veshura në zi e fëmijë jetimë e hise të fikura (shkretuara) plagë këto që nuk u shëruan kurrë e vazhduan për 50 vjet me burgje e internime, përbuzje e veçime të njeriut nga njeriu e nga shoqëria.

Dukagjini nder shekuj ka qenë kështjelle e lirisë, kështjellë e pamposhtur kundër pushtuesve të huaj. Dukagjini ka qenë shtylla kurrizore e katolicizmit i papërkulur as i pa tjetërsuar as nga sulltanët, s nga sllavet serbo – malazez, këtë e dinte mirë Enver Hoxha me emisarët sllavo – jugosllavë.

E vërteta e vrasjes të Çelo Sinanit dhe masakra e Jaho Gjollikut.

Me 26 nëntor 1944 brigada e 6-të partizane përqendrohet ne rajonin e Bruçajve.

Po në këtë datë ktheheshin nga Shkodra shumë shtegtar nga fshati i Xhanit, pasi kishin bërë tregun për festën e Shënkollit (5 Dhjetor 1944). Shtegtaret vathonin rrugën në grupe (Shkodër-Qafë Thanë-Bruçaj-Xhan). Kur kalojnë Qafë Thanën, nata po i zinte vendin ditës. Shtegtarët që kishin mushka dhe ata që i kishin më afër shtëpitë e vazhduan rrugën. Një grup shtegtaresh prej 9-të vetash sapo kaluan Qafën e Thanës ndalohen nga një repart partizan. Disa nga shtegtaret kishin marrë armë me vete (zakonisht dukagjinasi armën që dispononin i merrnin ngado nga shkonin, prezenca me armë u dukej burrëri). Partizanët ju kërkojnë armët, shtegtaret nuk pranojnë, me gjithë kundërshtimin ua marrin armët. Nata kishte mbuluar vendin, partizanë kishte kudo, shtegtaret

e lodhur vendosën të kalonin natën në familjet e njohura në Bruçaj.

5 Shtegtar me mushka vazhduan rrugën për në fshatin Khan nga Krojnat e Bardha. Tre partizane korrier me Çelo Sinanin vinin nga batalioni i përqendruar në Khan për në komandën e brigadës në Bruçaj. Nata sapo kishte mbuluar vendin, tre partizanët vazhdonin rrugën malore përpjetë e tatëpjete, 5 shtegtaret vazhdonin rrugën e drejtë, për nga “Krojnat

gjatë manovrimit me armën e vet.

Sipas versionit të popullit Çelua është vetëvrarë aksidentalisht, ky version nuk përjashtohet në qoftë se do kemi parasysh moshën dhe mungesën e përvojës në përdorimin e armës në të tilla raste.

Shtegtaret duke shfrytëzuar errësirën dhe terrenin munden të largohen duke lënë mushkat e ngarkuara me ushqimet e festës. Ata nuk dinin asgjë se është vrarë kush, as nuk dinin gjë se kush i kishte qëlluar.

Ne do dëshironim që dy shokët partizan të shkruanin për të vërtetën e asaj nate dhe në çfarë rrethanash humbi jetën Çelo Sinani, por jo të pa vërtetat e komandës të brigadës së Jaho Gjollikut, që një herë kanë informuar familjen se Çelua është vrarë duke luftuar me armikun Gjerman e herën tjetër duke gënjyer se Çelos ju kishte zënë pritë nga reaksioni. Ne i bëjmë më dije edhe familjes të Çelos se të dy thënie të komandës e të kujtdo tjetër janë gënjeshtra, janë të pavërteta, janë mashtrime.

Lidhur me Çelon e dy Partizanet

themi edhe një të vërtetë të Reizit, vëllait të Çelos.

Drekën e 26 nëntorit 1944 Çelua me dy shokët e kanë ngrënë në një familje në Khan. Ata janë nisur me shkua në Komandën e brigadës në Bruçaj ishin normal të përcjell nga familjet ku hëngrën drekën, dhe jo me alarm për

të shkuar në luftë me armikun duke u pamundësuar ngrënie e patateve për të shuar urinë. Kjo është një mashtrim një gënjeshtrë e paskrupullt, sepse brigada e gjashtë në asnjë moment nuk është përballur me asnjë gjerman dhe as me reaksionin siç i quajnë ata popullin fisnik e patriot të Xhanit e të Bruçajve.

Ne ndiejmë dhimbjen e nënës për djalin, por edhe ju duhet të ndjeni dhimbjen e nënave e motrave për dhjet malësoret udhëtar të pafajshëm që u pushkatuan në shenj hakmarrjeje për Çelon, krim ky që nuk duhet ta kishte bërë “shqiptari” Jaho Gjolliku dhe mbesa Sanije e Shefqet Peçit.

Ne u themi të vërtetën se Çelo Sinani ishte shkaktari që u vra, atij nuk ju kishte zënë pritë, as nuk është vrarë në prit siç ka gënjyer e mashtruar komanda e brigadës, këto kanë qenë të pavërteta për ti dhënë vlerë më shumë se duhet në sy të familjes e të tjerëve vrasjes së Çelo Sinanit.

Takimi i rastësishëm i 5 shtegtareve dhe provokimi i panevojshëm i tre partizanëve duke qëlluar shtegtaret u bë shkas



SHPALLET I PAFAJSHËM ARMIR GRIMA



Gjykata e Shkodrës ka dhënë vendimin duke e shpallur të pafajshëm ish-trajnerin e kombëtares së femrave, futbollistin e madh, mjeshtrin e sportit, Armir Grima.

Armiri dyshohesh si i përfshirë në grupin kriminal "Bajri".

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër i ka dhënë pafajësinë, ndërkohë që në gusht të këtij vit, çështja u transferua nga Krimet e Rënda tek Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër për mos kompetencë.

Vendimi u dha nga gjyqtari Tonin Stërkaj ndërsa prokurorja Edlira Cufi kërkoi pafajësinë për mungesë provash dhe gjykata dha pafajësinë.

Armiri, së bashku me shokë të tjerë akuzoheshin për trukim ndeshjesh për të cilën qëndruan për disa kohë në burg dhe

më pas nën masën detyrim paraqitje e arrest shtëpie. Për sa i përket Grimës masa e sigurisë për të u lehtësua më parë nga Gjykata për Krime të Rënda nga arrest me burg në arrest shtëpie. Më pas çështja ndaj tij i kaloi gjykatës së qytetit verior pas shpalljes së mos kompetencës. Shpallja e mos kompetencës për ish-kapitenin i skuadrës së futbollit të "Vllaznisë" dhe ish-trajnerin e fermave erdhi menjëherë pasi ndaj tij u hoq akuza e grupit të strukturuar kriminal. Më pas gjykata caktoi ndaj tij masën detyrim paraqitje. Grima ka qenë portier i ekipit të futbollit të "Vllaznisë" në vitet 1998-2001, në kohën kur ky ekip është shpallur kampion.

Armiri është zbuluar rastësisht nga përgjimet telefonike dhe akuzohet për trukim ndeshjesh. Ndeshja, për të cilën akuzohet trajneri i Kombëtares së femrave, Armir Grimaj, është ajo e luajtur më datën 5 maj të vitit 2018 mes "Vllaznisë B" dhe "Tërbunit". Ndeshja ishte përcaktuese për "Vllazninë B", e cila kërkonte që të mbijetonte në Kategorinë e Parë, në grupin B të saj. Për të njëjtën akuzë u arrestua edhe ish-portieri i Tërbunit, Fabiol Rexhepi, i cili u shpall i pafajshëm nga gjykata.

Vërtetë e tmerrshme, që të arrestohesh, të qëndrosh në paraburgim, pastaj në arrest shtëpie dhe të gjitha këto bashkë, për rreth 2 vjet! E gjitha kjo torture për paafësi të strukturave të drejtësisë. Sipas tyre, më se gjysma e popullit duhet arrestuar, se sa telefonata na bëhen apo bëjmë në interes të së mirës, por që personi komunikues mund të ketë kryer një krim dhe unë nuk di gjë?!

Torture për personin që arrestohet! Torture për prindërit, bashkëshorten, fëmijët, te afërmit dhe te shoqërisë! Të gjitha këto

duhen pasur parasysh, pa se ti vesh pranget tjetrit në duar. Por, dhe opinioni, imazhi për tjetrin, duhet menduar. Te gjitha duhen menduar.

Armiri ynë, urojme që kjo ndodhi të jete një kujtim i largët, sikur nuk ka ndodhur gjë, të hidhet pas shpine, të fitoni të gjitha te drejtat dhe ti vijoni jetën normale!

Të urojme gjithë të mirat!

Ndue Sanaj



MARASH KUMBULLA, PËRFAQËSUES I DUKAGJINIT NË KOMBËTAREN E FUTBOLLIT, REFUZOI ITALINË PËR SHQIPËRINË

Marash Kumbulla, 19 vjeçari, i cili refuzoi Italianë për Shqipërinë.

Sa i takon Marashit, ai ka marre emrin e gjyshit të tij, i cili ka ndërruar jete para se 19 vjeçari të lindte. Marashi ka lindur në Peschiera Itali, por rrjedhe nga një trung i fuqishëm, ku gjithmonë dalin filiza të rinj.

Në traditën e Dukagjinit, shumë familje kanë përcjellë brez pas brezi emrin e gjyshit. Një nder ta është dhe futbollisti i ri, që ka marre emrin e gjyshit, Marash Ndue Kumbulla nga fshati Kishë-Arrë (Dushman), sot Njësia Administrative Temal.

Gjyshi i tij Marash Kumbulla dënohet nga regjimi komunist, me 24 shkurt 1976 me akuzën "krimi i agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor" duke e dënuar me 8 vjet burg dhe konfiskim pasurisë.

Babai i tij, Lini deklaroi për shtypin italian kalvarin e vuajtjeve, ku falë 1000 liretare të siguruara emigron me gomone drejt Italisë. Sot jeton në Peschiera dhe thotë: "Jam i lumtur që djali zgjodhi Shqipërinë. Mund të bëhet ylli i kombëtares sonë dhe nuk ka kënaqësi më të madhe".

Drejtuesi kombëtares shqiptare Edy Reja, në intervistë për shtypin sportiv italian, me 16 tetor 2019 deklaroi: "Me Turqinë humbëm për një marrëzi,

çuditë si Italia nuk mori Kumbullën. Kam aktivizuar Kumbullën e Veronës, i cili ka zgjedhur Shqipërinë pasi është i lidhur me vendin e tij. Ka luajtur me të gjitha moshat e Shqipërisë dhe prindërit ishin për ta parë. Çuditë si Italia nuk ia ka hedhur sytë. Ata edhe e kanë kërkuar, por tashmë ai ka zgjedhur".

Marash Kumbulla ka finalizuar në debutimin e parë në ndeshjen me Moldavinë. Talenti i tij vlerësohet për progresin dhe rritjen e tij duke u cilësuar nder më të mirët në Evropë, duke u klasifikuar në 11-shen më të mirë të 5 ligave më të forta në futboll.

Aktualisht luan me ekipin e Verones, klubin në të cilin Kumbulla është rritur, formuar dhe më pas ka debutuar si profesionist.

Shpresojmë që karriera e tij do të ecë në rrugën e Lin Shllakut, kapitenit të kombëtares, por në rolin e mbrojtësit dhe sulmuesit, që të dy me origjinë nga një krahinë.

Shembulli i Marash Kumbullës të jetë një thirrje për shumë sportistë emigrantë dukagjinasi, që janë angazhuar në klube futbollit në Itali dhe vende të tjera, që të mos harrojnë vendin e origjinës.

Përgatiti Zef Nika, Bruksel



DOKUMENTI I STEFANO GASPARIT I VITIT 1671, HISTORIKU I SHKRUARJES DHE PUBLIKIMI I TIJ

KY DOKUMENT KONSIDEROHET MË I RËNDËSISHMI PËR HISTORINË E SHQIPËRISË PËR SHEKULLIN XVII.

Relacion apo Raport?

Në të gjitha rastet kur është komentuar ky dokument është cilësuar si "Relacioni i Stefano Gasparit i vitit 1671". Në të vërtetë ky cilësim me këtë emër ka qënë i padrejtë, sepse ky dokument nuk është një relacion në kuptimin zyrtar të tij. Mbas krijimit në Vatikan, në vitin 1622 të institucionit për përhapjen e fesë e quajtur Propaganda Fede, njëri nga vendimet ka qënë detyrimi për klerikët që punonin brënda kontinentit Evropian të dërgonin çdo vit nga një relacion për gjendjen në teritorin që ata administrojnë nga ana fetare. Ata që punonin në vende të tjera jashtë Europës, duhet detyrimisht të dërgonin një relacion së paku një herë në dy vjet.

Relacioni nuk mund të hartohet sipas dëshirës së njërit apo tjetrit klerik, por ishin caktuar një listë me 27 kërkesa mbi të cilat duhet të dërgoheshin të dhëna në mënyrë që në Vatikan të kishte të dhëna të mjaftueshme për të njohur realisht gjendjen e të gjitha rajoneve ku ata kishin vepërimtarinë e tyre fetar. Në vitin 1802 numri i pikave mbi të cilat duhet të përfshiheshin të dhëna në relacionet e dërguara ishte 69.

I parë në këtë këndvështrim ky dokument nuk është një relacion, por është një raport me shkrim për gjendjen në zonën e influencës së kishës katolike në Ballkan. Ky është kërkuar me vendosmëri nga Papa dhe është sponsorizuar me fond të veçantë nga kisha, ndryshe me relacionet që ishin një detyrim ligjor dhe një punë rutinë që duhet të kryhej nga Ipeshkvinjët, Vikarët Apostolik dhe meshtarët në zonat ku ata shërbenin.

I shkruar në 125 fletë dhe i shpërndarë në 211 faqe dorëshkrim, ky i tejkalon kufijtë e një relacioni informativ dhe ka rëndësinë e një studimi të plotë për zonat që ai i studjoi dhe i shkeli me këmbë për dymbëdhjetë muaj pa ndërprerje.

Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në faktin se popullsia e Shqipërisë së Veriut e përfshirë në teritorët e shtatë dioqezave, në shumicën dërmuese i kishte mbijetuar asimilimit fetar dhe nuk e kishte pranuar të bëhej renegat i fesë katolike në pjesën më të madhe të tij.

Këtë qëndresë e kishin bërë në mënyrë të pavarur dhe pa mbështetje nga Selia e Shenjtë për afër një shekull e gjysmë.

Në masë të madhe ata jetonin si shqiptar, por si të krishterë jetonin vetëm për forcë zakoni dhe jo sepse kisha romane

kishte treguar ndonjë përkujdesje për ta.

Mbas krijimit të organizatës për përhapjen e fesë në janar 1622 e quajtur ndryshe edhe Propoganda Fede, u krijuan organizma për të rimëkëmbur besimin e harruar nga një pjesë e popullsisë së vendeve të pushtuara nga Perandoria Osmane ku bënte pjesë edhe popullsia e Shqipërisë së sotme.

Për përmbushjen e këtij misioni organet më të larta të Selisë së Shenjtë në Vatikan vendosën të dërgonin një person për të paraqitur një panoramë të saktë të gjendjes së besimtarëve në këto treva.

Personi i ngarkuar me këtë punë duhet të shkonte fshat më fshat dhe të përshkruante në mënyrë të hollësishme realitetin në të cilin ndodhej popullsia e këtyre vendeve.

Duhet të sillleshin të dhëna për gjendjen dhe numrin e popullsisë, sa ishin konver-

social dhe politik.

Dokumenti përmban të dhëna të hollësishme për numrin e popullsisë, por edhe vendbanimet dhe emertimin e tyre edhe kur janë katër apo pesë familje.

Ka të dhëna gjeografike ku përfshihen emrat e lumenjëve, maleve, krahinave, kufinjtë gjeografik të tyre e të tjera.

Ka të dhëna me karakter ekonomik ku tregohet për llojet e bimëve që kultivoheshin, për prioritetet, për gjendjen ekonomike të popullsisë, për monedhat, për shërbimet që ofroheshin si fetare ose edhe shëndetësore deri edhe kirurgjikale.

Nisur nga këto informacione që përfshin ky dokument është konsideruar nga studjuesit e huaj dhe më vonë edhe nga ata shqiptar si dokumenti më i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë, për shekullin XVII. Por nëse një relacion i ngajshëm i Zmajeviqit i vitit 1704 është publikuar

i plotë dhe me fare pak gabime, dokumenti i Gasparit megjithë mjaft me rëndësi, ende edhe sot e kësaj dite është publikuar vetëm pjesërisht dhe me shumë gabime, të cilat vijnë të merren në konsideratë si burime historike të sakta dhe të prodhojnë shkrime me gabime, të cilat nga njëherë shkojnë deri në tjetërsim të realitetit historik.

Nga të dhënat arkivore merret vesh se dërgimi i Shtjefën Gasprit në Shqipëri për të raportuar për gjendjen e kishës katolike në këto treva, por edhe për gjendjen sociale dhe shoqërore të popullsisë së këtyre trevave, është iniciuar nga vetë Papa dhe është ndërmarë nga organet më të larta të shtetit të Vatikanit. Ai është përzgjedhur për këtë mision, sepse ishte me nacionalitet shqiptarë, njëjtë gjuhën dhe zonat në të shtatë Dioqezat me popullsi shqipfolëse, kishte mbaruar me sukses Kolegjin Ilirik të Loretos dhe Kolegjin Urbanian në Vatikan dhe mbi të gjitha ishte i njo-

hur edhe për një inteligjencë të mirë në raport me kolegët e tjerë.

E thënë ndryshe, ai në vitin 1670 kishte mbaruar dy shkolla të larta nga më në zë për atë kohë dhe kjo ishte padyshim një arritje shumë e madhe e tij.

Në fillim ofertën për të kryer një mision të tillë ai nuk e ka pranuar me pretendimin, se i rrezikohet jeta nga turqit, që kishin pushtuar këto zona dhe se i kishin ofruar një pagesë të pamjaftueshme.

Mbas disa muaj bisedimesh midis tij dhe eprorëve, është rënë dakort që ai të vizitonte dioqezat me banorë shqipfolës jo si klerik, por si një turist, qytetar i thjeshtë kundrejt një shume shumë të madhe monetare për nevojat të shërbimit si ushqim, fjetje, pagesë për kuajt dhe shoqëruesit dhe për ryshfetet që parashikohet se do ti duheshin për pushtetarët e korruptuar turq nëse ata do ti nxirrnin pengesa.

Shuma e madhe monetare, që i është vënë në dispozicion për të përmbushur misionin e ngarkuar, e vinin atë para përgjegjësisë, që detyrën e ngarkuar ta kryente në nivelin më të lartë të mundshëm. Në dokumenta e ruajtura në Arkivin e Propogandës së Fesë në Vatikan (APF) del krejtësisht e qartë, që Gasprit dërgohej në misionin e tij jo si **relator**, por si **eksplorator** dhe raporti që ai duhet të sillte duhet ti tejkalonte kufinjtë e një relacioni.

Prandaj ka kaq shumë rëndësi gjetja dhe publikimi korrekt i këtij dokumenti, sepse në të është përfshirë maksimumi i mundshëm i informacioneve, që mund të merreshin në atë kohë nga një person i huaj, nga vende kundërshtarë me pushtuesin osman të vendit tonë.

Në Shqipëri, ky dokument është publikuar për herë të parë në revistën Hylli i Dritës në katërmbëdhjetë numra gjatë viteve 1930, 1931 dhe 1932.

Nisur nga sa paraqitëm më sipër jemi të mendimit, që ky dokument nuk është e drejtë të emërtohet relacion, por raport mbi gjendjen kishtarë në shtatë dioqeza të shtrira në bregdetin ballkanik deri në thellësi të kontinentit evropian.

PUBLIKIMI I DOKUMENTIT

Historianët dhe studjuesit e ndryshëm që merren me histori ju kanë referuar këtij dokumenti që ata e kanë emërtuar relacion në dhjetëra shkrime të publikuara gjatë këtyre nëntëdhjetë viteve, për të ilustruar shkrimet e tyre duke sjellur shumë herë konfuzion dhe pasaktësi të "çertifikuara" me autoritetin e revistës prestigjioze "Hylli i Dritës".

I pari, që ka reaguar mbas këtij publikimi ka qënë studjuesi Fulvio Kordinjano, i cili në vëllimin e tretë të librit të tij me titull "**L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande Missionario italiano il P. Domenico Pasi S. I. 1847-1914**", botuar në Romë në vitin 1934, i ka kushtuar këtij dokumenti një kapitull të tërë, atë të dhjetin, nga faqja 321 deri në faqen 332 duke i bërë një analizë të thellë historikut të tij dhe publi-



◀ i duhur për Kishën dhe Ungjillin, për arsye të lakmisë së tij, e cila e bënte të kryente marrëzira.

6. Në Shkup ndër gjashtë priftërinj, 3 janë me vlerësim të mirë. Arkipeshkvi, Imzot Andrea Bogdani, është tashmë tetëdhjetë vjeç, por mjerisht shiste edhe ai Vajra të Shenjtë.

7. Në Arkidioqezën e Tivarit, një syresh ka vlerësim të mirë, tre nuk e ushtrojnë siç duhet detyrën priftërore, një është fajdexhi dhe shumë injorant.

Vizitori ankohet shpesh se Peshkopët e lenë veten të udhëhiqen nga qëllimet e tyre simoniake në zgjedhjen e Klerit, gjë nga e cila rridhnin të këqija të pallogaritshme; kështu nuk kishte një dorë të fortë në mënyrë që të jepet mësim Doktrina e Krishterë, të hiqeshin veset, të qortoheshin skandalet, në një Kler të ulët që në më të shumtën e rasteve ishte shumë injorant, aq sa nuk dinte të shkruante, lexojnë pak apo keq, kështu nuk kuptojnë atë që lexojnë dhe nuk mundën të kremtojnë Meshën e Shenjtë pa një mal gabimesh. Me pak fjalë, kishte humbur tërësisht jo vetëm shpirti eklesiastik, por edhe vetë shpirti i të krishterit.

Vizita e Gasprit ishte një lëvizje serioze nga ana e Propaganda Fides, lëvizje që do ta vinte në krye të Koncilit të Parë Shqiptar të vitit 1703. Aty ishte vetëm një prelat, Andrea Zmaieviq (Grykat e Kotorrit), për të cilin Gasprit bën një lëvdatë të përsosur dhe që duhej të ishte pararendësi i Vincenco Zmaieviqit, i cili me urdhër të Romës hapi në Merqinë Koncilin e lartpërmendur.

Është e dhimbshme që në një kohë me kaq shumë shturje, braktisje dhe apostazi, vetë Urdhëri i Shën Franceskut në Shqipëri, i cili madje kishte nxjerrë martirë, i braktisi pozicionet e tij, ato të një heroizmi misionar, e harroi zellin zanafillor. Në dallim nga Kleri i Ulët dhe Kleri i Lartë, i cili me përjashtim të Imzot Zmaieviqit, ishte asokohe vetëm Shqiptarë, Françeskanët kishin në radhët e tyre, në strehëzat e tyre, italianë, dalmatë dhe shqiptarë. Ja si gjykonte Gasprit:

“Për sa unë kam bërë në veprimet e kësaj vizite, kam gjetur se është shuar krejt në Etërit e lartpërmendur ai zell dhe dëshirë e zjarrtë që kanë pasur kur kanë hyrë për herë të parë në këtë Provincë, në mbajtjen dhe dhënien mësim të Doktrinës së Krishterë për rininë dhe zakonet e mira, meqenëse nuk e ushtrojnë më këtë funksion të shenjtë të tyre në asnjë vend të misioneve të tyre”.

Pavarësisht të gjitha këtyre, aty kishte ende disa priftërinj mjaft të zellshëm. Unë mendoj se mjedisi kishtar i përgjithshëm i bën që t’ju bjerë zelli i parë, si dhe duhet shtuar fakti se nuk duket të kenë qenë me fat dhe të matur në zgjedhjen e vokacioneve të reja për vendin, ashtu siç del nga shënimet e Gasprit.

Tani duhet të themi nëse e gjitha kjo mund të ketë ndodhur në një shekull persekutimi që ka pasur martirët e vet dhe ndërsa peshkopët merreshin ndër nxënësit e Kolegjit të Propagandës si dhe Kolegji i Loretos, atëherë cilat duhet të kenë qenë kushtet eklesiastike në periudhën që paraprinte pushtimin otoman, në mes pasurive, luftërash të brendshme dhe krahas skizmës, e cila kërcënonte kudo Shqipërinë? “.

Këtë kapitull Kordinjano e shkroi në vitin 1933 dhe e botoi në vitin 1934. Siç mund të kuptohet nga leximi i këtij shkrimi, Kordinjano kopjen e dokumentit të depozituar në Napoli nuk e kishte parë kur shkroi librin, por ai kishte në dorë kopjen e ruajtur në Arkivin e Propagandës Fide.

Më poshtë Kordinjano ka shënuar edhe 4 faqe të librit të tij me gabimet që ai kishte vënë re në botimin në “Hyllin e Dritës” të kopjes së dokumentit të Gasprit. Këto nuk po i përfshijmë në botim sepse lexuesi mund ti gjejë të shkruara qoftë në librin origjinal të Kordinjanos qoftë në përkthimin e këtij libri nga Ilirjana Angoni dhe botuar nga shtëpia botuese Plejad në vitin 2011.

Tani, mbas tetëdhjetë e shtatë viteve që është publikuar pjesa e fundit e kopjes së këtij relacioni të marrë nga Biblioteka Kombëtare e Napolit në Pallatin Mbretëror të këtij qyteti, marrë shkas nga gabimet e shumta që përmban ky publikim, vendosëm të merremi edhe një herë me këtë problem.

Për këtë arsye kemi marrë të plotë kopjen e këtij relacioni që gjëndet në Napoli dhe ruhet si dorëshkrim në 125 fletë, që të shkruajtura janë 111 faqe, në një dosje me rreth 450 faqe dokumenta të ndryshme.

Kemi marrë edhe kopjen që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan, edhe ky në dorëshkrim me mbi 120 fletë me 208 faqe pothuajse të shkruara të plotë.

Nga krahasimi i dy kopjeve të përmendura dhe i shkrimit të publikuar në “Hyllin e Dritës”, lehtësisht dallohet që ka ndryshime të mëdha midis kopjeve në dorëshkrim dhe tekstit të publikuar në revistën në fjalë.

Nga studimi që u kemi bërë këtyre dokumenteve kemi vënë re që kopjet dorëshkrim midis tyre kanë dallime dhe nuk janë kopjuar nga i njëjti person por nga dy kopjues të ndryshëm.

Teksti i publikuar në revistën “Hylli i Dritës”, është një rishkrim i kopjes dorëshkrim të Napolit por i rishkruar me më shumë se dyqind gabime.

Kopja që ruhet në Vatikan ka ndryshime të dukshme sepse ka të shkruara të dhëna që kopja e Napolit nuk i përfshin.

Ajo është shumë më e plotë se kopja e Napolit dhe ka disa paragrafe shkrime më shumë, me të dhëna që kopjuesi që ka shkruar kopjen e Napolit i ka lënë pa i shkruar për motive që për ne nuk janë të qarta.

Një hamendësim mbi mospërfshirjen e disa paragrafeve në kopjen e Napolit mund të jetë që ai u shkrua jo i plotë për të ruajtur disa të dhëna që për atë kohë mund të konsideroheshin sekrete. Kjo ide e jona mund të konsiderohet vetëm një hamendje e pa bazuar në të dhëna konkrete. Arsyeja e mos përfshirjes në kopjen e dokumentit të këtyre paragrafeve mund të jetë krejt tjetër nga ajo që mendojmë ne.

Nisur nga ky fakt, jemi të mendimit që duhet kërkuar në arkiva të tjera për të bërë të mundur gjetjen e kopjes origjinale të shkruar nga autori dhe të bëhet rishkrimi dhe publikimi nisur nga kopja origjinale. Mbase këtë gjë ne nuk e kemi arritur, atëherë kemi rishkruar korrektësisht kopjen që gjëndet në Arkivin e Propogandës Fide.

Jemi të mendimit, që kopja origjinale

mund të ndodhet në Arkivin Sekret ose në fondin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Apostolike në Vatikan. Nëse dokumenti origjinal do të gjëndet dhe të publikohet, atëherë do të zhduej çdo hije dyshimi mbi saktësinë e publikimi tonë.

Deri sot ky relacion është botuar dy herë por në të dyja rastet jo i plotë. Botimi i parë, siç e thamë më sipër, u botua në revistën “Hylli i Dritës”, në vitet 1931, 32, 33 në 14 numra.

Ky botim nuk është i plotë sepse nuk është e plotë kopja që gjëndet në Bibliotekën Shtetërore të qytetit të Napolit, në fondin Brancaciana sipas së cilës është bërë publikimi.

Botimi i dytë i këtij relacioni është bërë nga Albanologu Peter Bartl, në serialin e botimeve të tij Albania Sacra në 4 volumet e para. Ai ka botuar sipas kopjes që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan të dhënat për Dioqezat e Durrësit, Lezhës, Sapës dhe Pultit. Nuk ka botuar akoma të dhënat për Shkodrën, Tivarin dhe Shkupin.

Pra edhe ky botim është i pjesshëm, sepse nuk ka të shkruar tre nga shtatë Dioqezat e përshkruara në relacion.

PUBLIKIMI I DOKUMENTI NGA NE

Për këtë arsye ju vumë punës për një publikim të plotë të kopjes që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fide, edhe pse është kopje e dokumentit dhe jo origjinali i shkruar nga autori i këtij relacioni, por sepse është më i plotë.

Për të bërë një punë sa më cilësore ne vepruam në këtë mënyrë:

Morëm në mënyrë elektronike, të skaneruara me ngjyra, të dyja kopjet e dokumenteve në arkivat përkatëse. Riproduhuam nga një kopje për secilën në format A4 të shkruar bardh e zi dhe jo me ngjyra dhe i lidhëm si libra të veçantë.

Morëm nga revistat “Hylli i Dritës” të gjithë numrat ku ishte botuar dokumenti dhe riprodhuam një kopje të plotë të këtij botimi për ta patur si referencë për rishkrimin që do të bënim.

Vendosëm në tavolinën e punës tre kompjuterë rresht dhe shfaqëm në dy monitorët anësorë kopjet e dorëshkrimeve nga dy arkivat e përmendur. Kjo gjë na krijoi mundësinë që të shofim me ngjyra dhe të zmadhuar deri në 200% kopjet e dokumentit.

Të dyja publikimet e mëparshme të dokumentit i krahasuam me kopjet arkivore në dorëshkrim.

Mbas një rishkrimi me vëmendjen më të madhe të këtij dokumenti, vumë re se botimet e më parshme kishin mospërputhje me kopjet dorëshkrim në mbi 670 raste në të 208 faqet e rishkruara. Këto mospërputhje, jo gjithmonë e tjetërsojnë kuptimin e dokumentit por në disa raste kishte edhe gabime të palejueshme të cilat e ndryshojnë shumë kuptimin e tij. Ky tjetërsim, sjell pështjellim shumë të madh për studjuesit që shkruajnë histori me të dhënat që ofron ky dokument. Mospërputhjet më të rëndësishme janë, harrimi pa shkruar i disa fjalëve, shkruarja gabim e shifrave në disa raste, shkruarja gabim e emrave të vendeve në disa raste dhe të tjera gabime më pak të rëndësishme. Kompjuteri na ndihmoi që të bëjmë regjistrimin e të gjitha këtyre mo-

spërputhjeve dhe korrigjimin e shumicës së tyre.

Në disa raste kemi vendosur shënime sqaruese në fund të faqes

Përkthimi në shqip i dokumentave është bërë sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, por nganjëherë kemi toleruar duke i qëndruar besnik kuptimit të fjalisë në origjinalin italisht. Është si të thash një përkthim i lirë çka nënkupton përkthimin me saktësi të mendimit dhe jo domosdoshmërisht përkthimin fjalë për fjalë të tekstit. Kjo është një punë e vështirë që ka kërkuar shumë mund dhe kohë por ne jemi munduar të bëjmë më të mirën e mundshme.

Ne u munduam që këto gabime të zvogëlojmë sa të jetë e mundur më shumë por nuk mund ta themi me gojën plot se me këtë botim nuk ka më asnjë gabim ose mospërputhje.

Ka disa emra të pajisjeve kishtarë, të monedhave, njësive matëse të peshës dhe sipërfaqeve të cilat sot nuk janë më dhe nuk i kanë fjalët korresponduese në gjuhën shqipe. Për këtë shkak, jemi të detyruar që këto fjalë ti lemë në tekst ashtu siç janë dhe të vendosim në fund të librit një fjalor me spjegimet përkatëse për secilën fjalë.

Përveç dokumentit të Gasprit të vitit 1671, po vendosim në këtë botim edhe katër dokumente të tjerë të cilët ne i konsiderojmë me rëndësi, sidomos për historikun e dioqezave dhe të fiseve në zonën verilindore të Shqipërisë. Kemi sjellë për botim një relacion të vitit 1675 të Shtjefën Gasprit të shkruar me dorën e tij në pesë faqe format i vogël. Kemi sjellë edhe një relacion të vitit 1697 të shkruar nga Fra Egidio nga Armanto. Dorëshkrimi përmban 17 faqe dhe sjell të dhëna me shumë rëndësi për ndryshimet në sjelljen e pushtuesit turk ndaj popullsisë së fiseve të besimit katolik në veri të Shqipërisë mbas luftës Austro-Turke të vitit 1689 dhe për qëndresën e këtyre të fundit. Relacioni tjetër që kemi vendosur në këtë botim është ai i Fra Filipit nga Shkodra, vetëm dy faqe por me rëndësi shumë të madhe për informacionin që përcjell. Po botojmë edhe pjesën prej 11 faqe të relacionit të vitit 1703 të Vinçens Zmajeviqit, pjesën ku flet për Dioqezën e Pultit ku përfshihet edhe Tropoja e sotme. Këto dokumente kanë rëndësi të veçantë për historikun e fiseve Nikaj, Mërtur, Gash, Krasniqe por edhe për fise të tjera. Ne kemi mendimet tona për zhvillimet politike dhe shoqërore të ndodhura në atë kohë në fiset dhe krahinat për të cilat flitet në relacione por e pamë me arsye që të mos bënim shumë komente por tua lëmë në dorë studjuesve të tjerë nga këto zona për të bërë komente dhe për të nxjerrë konkluzione për atë se çfarë ka ndodhur në fund të Shek. XVII dhe në fillim të Shek. XVIII në ato zona. Mund të vendosim në fund të prezantimit të relacioneve ndonjë mendim fare shkurtazi vetëm për fiset Nikaj, Mërtur, Krasniqe dhe Gash. Ndoshta më vonë, mbasi të marrim në studim edhe disa relacione dhe dokumente autentike të tjera, mund ta themi mendimin për historikun e asaj periudhe në një tjetër publikim tonin me një këndvështrim më të gjërë.

ARTI I IBRAHIM KODRËS DHE FLAMURI SHQIPTAR

Para 30 vitesh, në shtator të vitit 1989 në Gjenevë, në kohën kur unë drejtoja Misionin shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, erdhi mjeshtri i madh, Ibrahim Kodra, ashtu siç ishte ai, fisnik, modest, komunikues. Biseda jonë zgjati shumë. Fliste me mall dhe pasion për Shqipërinë, për Mëmëdheun që e kishte lënë prej kohësh dhe që donte të linte një gjurmë të punës së tij të madhe gjatë viteve të kaluara në emigracion. Më paraqiti me modesti disa nga pikturat e tij që janë shpërndarë në të gjithë botën, midis muzeve të ndryshme, galerive dhe koleksioneve private tek të njohurit. “Shqipëria fantastike”, “Përbërja e vitit 1951”, “Muzikantët”, “Lufta për pushtet”, “Lufta për paqen”; këto janë vetëm disa nga 6000 veprat e

Pasi pa një pikturë nga Kodra, Picasso i shkëlqyeshëm thirri me entuziazëm: “Shoku im piktor shqiptar, një pikturë origjinale, madje edhe firma jote duket si një vizatim si veprat e tua!” Piktori i madh Ibrahim Kodra më tregonte pambarim gjithçka kishte kaluar gjatë jetës së tij dhe pengun që një pjesë të jetës së tij e kishte kaluar jashtë Atdheut, prej nga mbante mend trevat e tij jatë moshës së adoleshentit, gjyshin dhe nënën e tij për të cilën kishte akoma mall, Ishmin dhe gjithçka të bukur që i kishte lënë përshtypje. U shpreh se donte të prehej pikërisht atje ku kishte ardhur në jetë.

Ibrahim Kodra lindi në 22 Prill 1918 në fshatin Ishëm (Durrës). Në moshën 3 vjeç, ai ishte jetim dhe u rrit nga gjyshi i tij. Ai studioi në Shkollën e Mesme Teknike

brez piktorësh të viteve 1960-1970. Në vitin 1947 ai u takua me Paul Eluard dhe më 1948 me të famshmin Pablo Picasso. Në vitin 1953, ai mori pjesë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Universitetit të Parisit dhe vazhdoi të ekspozojë veprat e tij në të gjithë botën. Ai ka ekspozuar me Picasso, Chagal, Roualt, Dufy, Matisse dhe Modigliani në Ekspozitën Ndërkombëtare të Venecias. Punimet e tij gjenden në shumë antologji të artistit në muze të ndryshëm në Europë, Amerikë dhe në pannaire të artit ndërkombëtar. Për më shumë se 30 vjet, ai jetoi në Milano, ku vdiq në 7 shkurt 2006. Piktori që kishte miqësi me artistët më të mëdhenj të epokës nuk e harroi asnjëherë origjinën shqiptare. Nëna e tij dhe Shqipëria ishin gjërat më të shtrënjta për të. Vizatimet e para për nënën

Vinçit dhe Mikelanxhelos”. Kaq mjafton për të zbuluar ngjashmëritë. Efekti i “V”-së, formuar në pikturën “Darka e fundit” të Da Vinçit, midis Krishtit dhe Maria Madalenës është një mesazh. Nëse Dan Braun, autori amerikan i romanit “Kodi i da Vinçit” do të njihje dhe Ibrahim Kodrën, ndoshta do të gjente një hapësirë më të madhe për të zgjeruar idetë e tij.

E bëmë këtë digresion për të treguar se nëse në të kaluarën figura e artistit të madh është anashkaluar tek ne, sot ai kujtohet me respekt. Në vitin 1996 ai u nderua me titullin “Nderi i Kombit”. Ai ka një koleksion të pasur çmimesh, ku mund të evidentojmë: Medalja e Artë e Akademisë Franceze, Qytetar Nderi në shumë qytete të Italisë, çmimi “Ambrogini i Artë” nga Bashkia e Milanos. Një punë të mirë në këtë drejtim për njohjen e veprës së tij, bën Fondacioni Zvicëran “Ibrahim Kodra”. Ky fondacion u themelua në Lugano për të transmetuar mesazhin e artit të artistit europian Ibrahim Kodra, si një instrument për paqen dhe kulturën, si një fije e përbashkët që lidh popuj të ndryshëm. Zonja Maria Pacolli,



famshme që mbajnë firmën e Ibrahim Kodrës. Ata zbkurojnë dhomat e Vatikanit dhe Dhomës së Deputetëve apo ndodhen në galeri publike, muze dhe koleksione private në Itali, Zvicër, Danimarkë, Gjermani, Japoni, Angli, Francë, SHBA, Rusi, Australi, Brazil, Argjentinë, Greqi, Shqipëri, Jugosllavi, Kosovë, Iran, etj. Kodra “primitivi i një civilizimi të ri”. Kështu e cilësoi poeti i madh francez, Paul Eluard mjeshtrin Ibrahim Kodra në 1946 në faqet e “Unité”. Ibrahim Kodra me modesti më tregoi se në 1948 mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Paqes, ku pati mundësinë të takojë personalisht me Pablo Picasso, takim që e shtyu drejt lëvizjes së tij artistike, jo vetëm si dishepulli i tij, por me individualitetin artistik.

“Harry Fultz” në Tiranë, dhe njëkohësisht u fut në një klasë pikturë në shkollën e parë të vizatimeve nën drejtimin e skulptorit Odhise Paskali (Artist i Popullit). Në vitin 1938, falë një burse, ai realizoi ëndrrën e tij për të shkuar në Milano dhe për tu regjistruar në Akademinë e Arteve të Bukura në Brera, ku mjeshtrat e tij të parë të pikturës ishin Carrà, Carpi dhe Funi, ndërsa në skulpturë, Francesco Messina. U përfshi në lëvizjet artistike të pasluftës, një periudhë që korrespondonte me epokën e surrealizmit, ekspresionizmit, kubizmit dhe futurizmit. Ibrahim Kodra, brenda këtyre formave të artit, realizoi rrugën e tij të veçantë që u quajt “primitivi i një civilizimi të ri”. Pa dyshim, Kodra ishte një nga më të dalluarit nga një

i ruajti gjatë gjithë jetës. Ndërsa flamurin shqiptar e mbajti me vete edhe në shtratin e spitalit ku mbylli sytë. Më 10 shkurt 2006, u organizuan homazhe në Teatrin e Operas dhe Baletit të Tiranës, përpara se të merrte rrugën për në vendlindjen e tij, ku u varros. Trupi i tij prehet paqësisht para derës së kalasë antike në Ishëm. Shtëpia e tij në Milano u bë “Muzeu Ibrahim Kodra”, ku artistë, talente të rinj dhe artdashës shkojnë të admirojnë veprat e tij. Kodra është konsideruar si piktori më i rëndësishëm shqiptar i njohur ndërkombëtarisht. Në librin “Kujtime”, të shkruar nga Ibrahim Kodra, thuhet: “Ishte marsi i vitit 1984 dhe ekspozita ime “Fantastikja në art” bëri shumë bujë sepse gazetarët shkruanin se Kodra qëndron midis Da

Presidentja e këtij fondacioni me prestigj, tepër komunikuese, fisnike, modeste, por e angazhuar më së miri me këtë projekt, thekson se në bashkëpunim me institucione në Shqipëri, Kosovë, Itali dhe të tjerë, “Fondacioni mbështet dhe zhvillon projekte kulturore, sociale dhe edukative, duke promovuar shkëmbimin kulturor midis Zvicrës dhe vendeve të ndryshme të botës”. Falë bujarisë së donatorëve të tij, Fondacioni mbështet projekte të reja kulturo-arsimore. Një prej tyre është dhe Projekti Eopart 2019 me temën “Arti dhe liria” që u prezantua nga Fondacioni Zvicëran Ibrahim Kodra.

«Çdo fëmijë është një artist, por problemi është se si të mbetemi të tillë edhe kur të rritemi», tha Pablo Pi-

29 SHTATORI Rivers Day 2019 “DITA BOTERORE E LUMENJVE”

Dita Botërore e Lumenjve është një festë e rrugëve ujore në botë. It highlights the many values of rivers and strives to increase public awareness and encourages the improved stewardship of rivers around the world. “Rivers are the arteries of our planet;

“Lumenjtë janë arteriet e planetit tonë” they are lifelines in the truest sense.”

Dita e Lumenjve synon të kujtojë njerëzit se sa të rëndësishme janë të gjitha rrugët ujore përreth globit për ne. Qëllimi kryesor i Ditës së Lumenjve është të sigurohet që të gjithë janë të vetëdijshëm për rëndësinë e administrimit të lumenjve dhe që të gjithë ne bëjmë gjithçka që mundemi për të kufizuar kërcënimet që mund të rrezikojnë lumenjtë tanë. Ekziston një shumë e veprimtarisë njerëzore që shkakton ndotje dhe dëmtim të një numri të rrugëve ujore të rëndësishme në botë, dhe kjo është e rrezikshme për njerëzit që përdorin rregullisht lumenjtë si burim uji dhe transporti, si dhe ekosistemet që mund të jetojnë në to. The very first Riv-

ers Day was celebrated in 2005 and since then it has been gaining in popularity with many events being organized around the world. Dita e parë e lumenjve u festua në 2005 dhe që prej asaj kohe ajo është duke fituar popullaritet me shumë ngjarje që organizohen në mbarë botën. In this same year, the United Nations also launched its Water for Life Decade, with the aim of increasing the awareness of the need for taking better care of the world's waters. Në të njëjtin vit, Kombet e Bashkuara filluan gjithashtu Dekadën e saj Uji për Jetën, me qëllim të rritjes së vetëdijes për nevojën për t'u kujdesur më mirë për ujërat e botës. Dita e lumenjve është e Diela e fundit e muajit Shtator në çdo vit


Lumi i Kirit, lumi i vendlindjes

Lumi i Kirit ka një gjatësi prej 52 km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës afro 261 km² dhe pjerrësia e shtratit 27 m/km. Në pjesa e sipërme e bazenit shtrihen fshatrat e Njësisë Administrative Pult, ndërsa në pjesën e poshtme fshatra të Njësisë Administrative Postribë. Lumi Kir, buron nga rrëza jugore e Majës së Elbunit në vendin e quajtur Nderkirska të fshatit Plan, pasi i bashkohen disa rrëqe në kete fshat bashkohet me përroit e Gjurajve dhe rrjedh me drejtim jug ku i bashkohet Përroi i Zabelit vazhdon përsëri drejt jugut i bashkohet përroi Megerrit Kirit, në vazhdim i bashkohet Përroi i Shkurtit të Xhanit, në vazhdim i bashkohet përroi Marknonajve të Kirit. Lumi hyn në luginën e Kirit për të vazhduar në këtë luginë të ngushtë ku i bashkohet përroi i Likajve deri në fshatin Prekal. Tek ky fshat pasi merr dhe disa përrenj që zbrasin nga shpatet e malit të Cukalit ai bën një kthesë të menjëhershme për nga JP, Ai

merr me vete dhe disa përrenj të tjere në Urën e Shtrenjtë, në Rreshek, në Drisht, etj, derisa përfundon në lumin Drin në afërsi të qytetit të Shkodrës. Prurja mesatare vjetore e Kirit është 17 m³/sek,

Lugina e Kirit, është ndër luginat e bukura që përmyll Alpet Shqiptare, është vizituar pak dhe akoma me pak e studjuar, ndonjë ka shumë vlera kulturore dhe entnografike me disa vendbanime të hershme me kështjella që akoma nuk janë të regjistruara në sited arkologjike. Është një luginë shumë e pasur me bimësi të gjitha zonave fitoklimetike që gjenden në Shqipëri. Në pjesën e sipërme të bazenit, në Pult zhvillohen masivet me geshtenja që veshin shpatet e maleve dhe kodrat në çdo fshat, në shpatet e maleve që lartësohen mbi 2000 m rriten rrobujt shekullor. Ka dhe drurë të tjerë frutor si; molla, arra, kumbulla, thana, lajthia etj. Lugina, ka një faunë të pasur pasi shumë sektorë në luginë janë me pyje të virgjër dhe të pashkelura nga njeriu. Në luginën e Kirit ka pasur dhe vazhdon të ketë riqebull, ndoshta më shumë se në çdo habitat tjetër në Shqipëri.

Mungesa e një rruge auto për lëvizje normale nga Prekali në fshatrat e Pultit dhe për në Shosh e ka lënë deri sot këtë



Sektor i Luginës Kirit në Boks

Foto, Fran Kodra

luginë si të braktisur. Turizmi ekologjik me shumë shtegtime që mundësohen nga Pulti në zona të tjera nëpërmjet shumë qafave me emër në këtë zonë duhet konsideruar si një prioritet zhvillimi dhe mundësi jetese për ata që banojnë sot atje, pse jo dhe të tjerë që mund të kthehen. Deri sot, lumi Kir, aq më pak e gjithë luginë me pasuritë që afron nuk janë të promovuara sa dhe si duhet. Zona e Pultit me gjithshka që ofron mund të konsiderohet si “Parajsja e panjohur e turizmit rreze Alpeve”.

Përgatiti; Gjon Fierza, Agjencia Kombëtare Mjedisit

caso.

Po çfarë është liria? Çfarë është arti? Çfarë është liria e shprehjes?

Fondacioni i bëri këto pyetje nxënësve të shkollës së Artit Pamor “Adem Kastrati” në Gjilan, Kosovë-brezit të ri të kësaj toke të vuajtur, e cila po rilind nga pasojat

e rënda të së kaluarës.

Liria e shprehjes artistike është e lindur në çdo qenie njerëzore. Pra, përgjigjet më të bukura të pyetjeve që shtruan në vetë janë imazhet e artistëve të rinj, mënyra e tyre pozitive për të parë botën duke respektuar të tjerët dhe veten e tyre.

Maria Pacolli, Presidente e Fondacion-

it „Ibrahim Kodra“, pohon rëndësinë e të rinjve për të shprehur lirshëm shprehjen e tyre artistike, sepse “një person, duke u rritur, duhet ta shohë botën më të bukur dhe më të lirë. Dhe për këtë arsye Fondacioni Zviceran Kodra është i përkushtuar të ndihmojë duke ndërtuar, nga brezat e rinj, një shoqëri më njerëzore, ku kultura është e domosdoshme për qytetërimin tonë, ashtu si ëndëroi mjeshtri Kodra, dhe i cili e shprehu këtë koncept në veprën e tij metafizike “Qyteti i ri”.

Fondacioni mbështet projekte kulturore-arsimore në bashkëpunim me institucione të ndryshme ndërkombëtare. Një nga projektet e fundit “Urbanistika e Re dhe Kultura e Bashkëjetesës në Kosovë” / “Bashkëjetesa natyrore dhe kulturore në Kosovë” u paraqit gjatë Biallës së Arkitekturës në Venecia në 2018 dhe u ekspozua në Parlamentin Europian në Strasburg në 2019, dhe pastaj preku vendet e tjera.

Gjatë këtij Panairi

ËopArt është ekspozuar punimi “Nënë Tereza e Kalkutës - Little Great Mother” nga Mjeshtri Ibrahim Kodra. Aty janë paraqitur edhe litografitë e veprave të Ibrahim Kodrës “Lugano Fantastica”, një tablo plot ngjyra dhe dritë që na ndriçon të gjithëve, dhe “Città Nuova”, në një seri të kufizuar prej 25 kopjesh artistike, të realizuara me rastin e ËopArt.

Në hapjen e prezantimit të këtij projekti interpretuan Maria Gridneva dhe Vitality Makarenko nga „Open Opera Project“.

Ky projekt u mbështet nga artistë ndërkombëtarë: Nxënësit e Shkollës së Artit Pamor „Adem Kastrati”, Gjilan (Kosovë); Alberto Amadori - arkitekt, piktor dhe skulptor; Alex Doll - piktor; Alfred Basha - ilustrues; Bajram dhe Fahrija Mehmeti - piktorë; Ellen Frank - artist; Engji Jaha - piktor; Francesco Corbetta - fotograf; Giulia Ilina - fotografe dhe gazetare; Grazia Giani - artiste dhe terapiste arti; Irina Markova - piktores; Luca Missoni - fotograf; Studio e Viaceslav Vladimirovitch Shichkov (V.V. Shichkov; Maria Pacolli Shichkova; Natalia Sivacheva, Sofia Shichkova; Zake Prelvukaj - piktor, kritik arti dhe skenarist.

Gjatë vitit në vazhdim janë parashikuar dhe veprimtari të tjera kulturore të Fondacionit “Ibrahim Kodra”.

Alfred Papuçiu



Presidentja e Fondacionit “Ibrahim Kodra” gjatë paraqitjes të projektit

EFEKTET E SINDROMËS SË "SHKREPJES SË FOTOVE" NË SHËNDETIN MENDOR



Nga Suela Ndoja

Mund të ndodhemi në një park, mund të jemi në mesin e një lëndine plot me ngjyra, në një koncert me drita neoni që reflektojnë shkëlqyeshëm ballin ose fytyrën tonë, në frontin e monumentit historik ose arkeologjik me shoqërinë tonë që tregojnë me hollësi dashurinë për kulturën. Apo ndoshta jemi vetëm duke lexuar, gatuar, dëgjuar duke dëgjuar muzikë, duke punuar në kopshtin e shtëpisë tonë... etj.

Pastaj ndodh: shtrijmë krahun, buzëqeshim dhe ja ... shkrepim një foto". Është e paqartë. Bëjmë një tjetër foto përsëri. Edhe një herë. Ah...Po, kjo është tamam një foto e artë. Fshijmë ato të shëmtuarat dhe zgjedhim atë të cilën e postojmë me një titull të butë ose thjesht të shkurtër: "Vetëm një ditë tjetër në park!" ose "Asgjë më mirë se një natë

hje të vlerësimit të numrit të fotografive të marra. Për shembull, sipas autorëve Bandaru & Patiejunas, (2015) Facebook raporton se përdoruesit në mbarë botën ngarkojnë dy miliardë foto në ditë dhe Instagram (2015) përdoruesit ngarkojnë 80 milionë foto në ditë. Le të mendojmë se çfarë tregojnë këto shifra.....?.

Kjo tregon se në të vërtetë, marrëdhënia jonë me fotografitë po ndryshon me shpejtësi. Ky ndryshim galopant, nga këndvështrimi im personal po shndërrohet në një "sindromë" të cilës nuk i referohem si një simptomalogji në vetvete por si një kombinim karakteristikash të opinioneve, emocioneve ose sjelljeve të caktuara lidhur me demonstrimin publik të eksperiencave personale. Ky kombinim krijon "reaksiione" mendore, fizike, emocionale dhe sjellore të cilat prodhojnë efekte në të gjitha strukturat e vetëdijes apo në vetëdijes tonë...

Cilat janë efektet e kësaj sindrome të "shkrepjes së fotove"?

Le të fillojmë nga efektet pozitive.

Teknologjia moderne në "shkrepjen e fotove në këtu dhe tani" ka krijuar rehatinë që nuk kemi nevojë të lëvizim fizikisht sa më shumë për të bërë një fotografi, na bën të ndihemi më shumë në momentin e dhënë.

Vetitë "frymëzuese" për të publikuar "eksperiencën e momentit" që synojnë të paraqesin "vetëveten më të mirë" nuk janë

pozitive të jetës, rrit vetëvlerën dhe madje ul kortizolin e hormoneve të stresit.

Gjithashtu tashmë shkenca flet për të ashtuquajturën "shkuarja me rrjedhën". Keni dëgjuar ndonjëherë për këtë koncept? Gjithashtu i njohur fjalë për fjalë si "të qënurit brenda në zonë", si gjendje mendore e funksionimit në të cilën një person që kryen një veprimtari është i zhytur plotësisht në një ndjenjë të përqendrimit të energjisë. Pra, shkrepja e fotos në momentin e tanishëm, në cast, na ndihmon të jemi brenda zonës së rehatisë, duke rrjedhur me kohën në të cilën jemi, duam të jemi dhe dëshirojmë tua bëjmë të njohur të njohurve tanë. Në këtë mënyrë, I gjithë procesi i shkrepjes së fotove - nga të zgjedhurit e një momenti deri tek zbulimi i këndeve të reja deri te dëshira spontane për të ngjyrosur foton më të pëlqyer me më shumë dritë ndriçuese - kërkon një përqendrim absolut dhe kohë të konsiderueshme. Vetë procesi i vëzhgimit se ku dhe kur duam ta bëjmë foton, për nga natyra, kthehet në një detyrë medituese që na tërheq në një gjendje paqësore dhe na angazhon në një fushë krijimtari dhe poezie se si duam t'ia vëmë titullin fotos së përzgjedhur për ta publikuar.

Megjithatë, ndërsa ne vendosim, ruajmë dhe komunikojmë me mijëra imazhe në telefonat celularë dhe kompjuterët tanë, një numër hulumtuesish dhe teorish tashmë po fillojnë të tregojnë për disa nga

sjes" që demonstronë sidomos moshat e reja në përgjigje të kërkesave të frikshme të përhapjes dhe mirëmbajtjes së imazhit publik.

Në shtesë të kësaj, standardet e paarsyeshme ose të pamundura të bukurisë të krijuar nga shkrepja e fotografive më të bukura mund të rezultojnë në ndjenja individuale të të metave, të mos krahasimit me të tjerët, ose të mos qenit mjaft i mirë".

Me kalimin e kohës, është e mundur që një individ të integrojë këto ndjenja, të cilat mund të rezultojnë në vetëvlerësim të ulët, vetëbesim të zvogëluar dhe ndjenja trishtimi dhe depresioni ".

Në këtë mënyrë, rrjedha e vazhdueshme e informacionit pamor kontribuon në atë lloj të fokusit të fragmentuar që quhet "vëmendje e pjesshme e vazhdueshme".

Me fjalë të tjera, duke qenë gjithnjë të sintonizuar dhe përgjegjës ndaj teknologjive digjitale, bëhemi më pak të vetëdijshëm për mjedisin tonë. Ndërsa vëmendja jonë i nënshtrohet hipnotizimit së të qenurit diku tjetër, përqendrimi ynë vuan. Pra, një përmbajtje e vazhdueshme e fotografive nuk frymëzon në mënyrë aktive kujtesën ose nuk krijon mirëkuptim.

Kështu, duke analizuar efektet dualiste të kësaj sindrome, gjejmë që nga njëra anë mund të përdorim praktikën e "fotografimit" si një mjet për të mirëmbajtur dhe rinfreskuar botën rreth nesh në të cilën duke kapur një skenë shprehim një formë krejtësisht unike të shprehjes të mbushur me nuanca dhe këndvështrime dhe vlera individuale. Me pak fjalë, mund të zgjidhim atë që përqendrohemi dhe atë që lëmë jashtë kornizës. Kjo gjendje mendore nuk është vetëm e mirë për shëndetin tonë mendor; është gjithashtu shpesh aty ku bëjmë punën tonë më të mirë krijuese. Nga ana tjetër nuk ka të bëjë me fotot në vetvete; është më shumë rreth procesit të krijimit të imazheve dhe angazhimit të tepruar emocional, mendor dhe fizik.

Së fundmi, rekomandimi nuk ka të bëjë me të ndaluarit e të bërit foto, por të shkrepim fotot me dhe për një mendje të shëndetshme, me dhe për një ndjenjë më të madhe të arritjeve personale, dhe një mënyrë për të kuptuarit e një bote shpesh të ndërlikuar duke mbajtur parasysh gjithnjë se duhet të kujdesemi që kjo "sindromë" të mos na kthehet në një kompulsion "për të shkrepur me patjetër dhe se s'bën një foto". Kur jeni duke u angazhuar në shkrepjen e fotove si një formë e vetë-shprehjes, nuk ka mënyrë të drejtë ose të gabuar për të bërë gjëra. Gjëja më e rëndësishme është që ta ndjeni dhe ta mendoni atë në mënyrë të natyrshme. Kjo mënyrë ndihmon të jeni të ekuilibruar dhe të gatshëm për të kaluar pjesën tjetër të ditës duke praktikuar qetësi mendore dhe shpirtërore,

Kështu që vazhdoni ... relaksohuni, vëzhgoni dhe "shkrepni foto" për një ditë më të mirë.



në koncert!"..etj, Tani le të mendojmë.... Mos të themi që nuk e kemi bërë....

Kjo pasi, me risitë e fundit teknologjike dhe disponueshmërinë e gjerë të telefonave celularë me kamera, "shkrepja e fotove" është bërë një aktivitet i përditshëm dhe i kudogjendur për miliona njerëz nëpër botë. Numri i fotografive të ngarkuara në faqe të ndryshme të mediave sociale çdo ditë mund të sigurojnë një lid-

vetëm për mbledhjen e "pëlqimeve" apo emoj të ndryshme si imazhe fantastike që janë- po ato janë gjithashtu një mënyrë efektive për njerëzit në përgjithësi që të shohin një rrugë drejt sjelljeve dhetributeve që ata dëshirojnë për veten e vet.

Gjithashtu gjetjet në kërkime shkencore tregojnë se jo vetëm që fotografimi lejon të shprehim vetveten, por gjithashtu ndihmon që të përqendrohemi në përvoja

efektet e padëshiruara të këtij "mbingarkimi të imazhit" në shëndetin mendor që variojnë nga ankthi i rritur deri te dëmtimi i kujtesës.

Sociologu Martin Hand në librin e tij "Ubiquitous Photography" shkruan se "Imazhet prodhohen, shndërrohen, bëhen publike dhe qarkullojnë në një shkallë të paparë". Ai gjithashtu vë në dukje "shkallën e ankthit, shqetësimit dhe magjep-

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi

JA KANË ZBARDH FAQEN SHQ-IPNISË!

Djemtë e Shalës së Dukagjinit,
I kane zemrat prej floririt,
Shala e mendjes e trimnisë,
Djepi shqipeve të lirisë,
Faqja e bardhe e shqiptarisë,
Në çdo tërvësë e kuvend,
Burrat t' njoftun plote me mend.

Në çdo kulle ka histori,
Plote me vepra e lavdi.
Mark Lula po kuvendon,
Siç e ka burri i traditës,
N' Prizren i peshoi fjala,
Shpate liric gjithmonë Shala.

Mehmet Shpendi me djelmni,
Turk as shkja si la me hi,
Me fe t' Krishtit nuk ka lojna,
Sa t' jetë gjallë njaj Kole Mark Kola,
Mal me borë besa e shaljanit.
Shtatë shaljanet ndera e vatanit.

N' Shalë kanë le mendjet e holla,
Mark Sadiku e Avdi Kola,

Gjithë ku u shtri dora e pajtimit,
Në shërbim të shqiptarizmit,
Ndok Gjeloshi shume trimnisht,
N' Vjen t' Austrisë luajti gisht.

Mirash Vuksani burrë i radhe,
Për ma t' forte nuk pat shqiptare,
Si në palestër e në tapet,
N' histori skalite si mbret,
Pesëmbëdhjete here kampion në Shqipni,
Por ma kampion n' vepra e burri,
Lart ja çoj emrin Dukagjinit,
Mesazh t' madh i la njerëzimit.

N' shtatëqind shpi tërvësë e buke,
Mirash Ndue e Sadri Luke,
Ndera e besa dhe burrnia,
Gjon Marashi e Bale Marku ishin lavdia,
Vlera e shqipes aty rrinë,
Nderi i Kombit Dukagjini.

Ilmi Kurti

HERONJTË E VIGUT

Ju ishit pesë yje,
Që ju thirri Liria

Jetën tuaj bëtë fli
Të rronte Shqipëria

Luftuat pushtuesin
Luftuat tradhëtarin
Kudo që e ndeshët
Ia bëtë varrin.

Luftuat për drejtësinë
E për të vërtetën;
Për Atdheun dhe lirinë
E dhatë edhe jetën!

Se për ju Liria
Dhe e vërteta,
Ishte më e shtrenjtë
Edhe se vetë jeta!

Pesë djem të rinj
Pesë djem levendë
Atdheut të shtrenjtë
I shtuan një legjendë!

BUKURIA E SYVE TË TU!

Shtat selvi, belin e hollë,
Faqe kuqe, por si mollë,

Sytë e zinj, flokt' kaçurele,
E bukur si lule dele!

E gjithë dita më kaloj
Tuj prit, e tuj mendu
Kur t' vij mramja të shikoj
Bukurin' e syve tu!

Bukurinë e shkëlqimin
Që më ndezin dashuninë
Jeta qenka shumë e bukur
Kur ke pranë lumturinë.

PËRSE E VRASIM SHOQI-SHOJNË?!

N' vend që jetën ta gëzojmë,
Përse e vrasim shoqi-shojnë?!

Jetën që na ka falun Zoti
S' mund t' ia marrësh askërkuj,
Por të gjithë ta gëzojmë
Pa eksese e pa bujë!

Ndue Mici

të dijmë *** të dijmë *** të dijmë *** të dijmë *** të dijmë *** të dijmë *** të dijmë

SI I VENDOSIN SHKENCËTARËT EMRAT E URAGANEVE?

Uragani 'Dorian', duket i pandalshëm. Ai shkatërroi ishullin e Bahamasit në Karaibe, dhe më pas u përplas mbi SHBA. Forca e tij, ka bërë që Qendra Kombëtare e Uraganëve në SHBA ta krahasojë me Uraganin e Ditës së Punës të vitit 1935, që ishte stuhia më e fortë e krijuar në oqeanin Atlantik në historinë e regjistruar.

Të mos harrojmë Uraganin Katrina e gushtit të vitit 2005, i dyti më i madh për sa i përket dëmeve ekonomike, dhe gjithashtu uraganët Sendi, Kamila, Endrju dhe të tjerët.

Të gjithë këto uragane kanë emra të veçantë. Por si vendosen ato? Sikurse shpjegon Qendra Kombëtare e Uraganëve, zgjedhja nuk është e rastësishme.

Nëse uragani është "femër"

Midis fundit të 1800 dhe fillimit të viteve 1900, shumë uragane në Inditë Perëndore (zonat dhe ishujt midis Floridës dhe Venezuelës), identifikoheshin me emrin e shenjtorit të ditës kur ndodhnin. Më vonë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, meteorologët e ushtrisë dhe marinës filluan t'u vënë uraganëve emra grash.

Kjo metodë ishte aq e thjeshtë, saqë Qendra Kombëtare e Uraganëve e miratoi atë. Kështu, duke filluar nga viti 1953, uraganët merrnin zakonisht emra femërorë. Vetëm në vitin 1978, u përfshinë edhe emrat mashkullorë për gjysmën e uraganëve, me një "barazi gjinore" edhe për ciklonet tropikale.

Emrat e uraganeve sot

Aktualisht Organizata Botërore e Meteorologjisë ka 6 lista, secila me 21 emra mashkullorë dhe femërorë, që përzgjidhen për të emërtuar uraganet. Ideja është që secila prej listave të jetë e vlefshme për një vit të caktuar. Për shembull për vitin 2019, ekziston një listë me 21 emra të mundshëm për 21 uraganë.

Dhe në rastin konkret u zgjodh emrin Dorian. Ndërsa për vitin 2020, janë në dispozicion 21 emra të tjerë e kështu me radhë, deri në listën e gjashtë me emra, që do të jenë të vlefshëm për vitin 2024. Më pas, nga viti 2025, do të nisë të përdoret sërish lista e parë.

Edhe zgjedhja për të pasur vetëm 21 emra për secilën listë nuk është e rastësishme. Pasi çdo emër fillon me një shkronjë të ndryshme të alfabetit. Nëse do të kishte më shumë se 21 uragane në një vit, meteorologët do të nisnin të përdornin shkronjat e alfabetit grek, duke i quajtur uraganët Alfa, Beta, Gama etj.

Dorian, një emër jo shumë i përhapur

Dorian nuk është një emër shumë i përdorshëm në Amerikë. Për shembull, nga rreth 14 milionë banorë të shtetit të Floridës, vetëm 857 quhen Dorian. Kur e dëgjon këtë emër, të vjen menjëherë ndërmend "Portreti i Dorian Greit", romani i mirënjohur i Oskar Uajlld në të cilin protagonist kryesor bën një pakt me Djallin për të mbetur i ri, ndërsa portreti i tij në një tablo do të plakët.

"MË I VJETËR SE KRISHTI", ULLIRI 2500-VJEÇAR NË TIVAR

Banorët në qytetin portual të Tivarit, në Mal të Zi,

thonë se një pemë ulliri është më e vjetër se Krishti, me një moshë prej afro 2 500 vjetësh. Ulliri i Vjetër, siç edhe quhet zona pranë Tivarit, ka marrë emrin e pemës mijëvjeçare dhe është një destinacion i njohur turistik. Për breza me radhë, vendasit e kanë cilësuar atë si një vend të shenjtë.

MBISHKRIMET MISTERIOZE TË SHPELLËS, KUR LUHEJ "LACROSSE" NË 1828-ËN

Një ekip studiuesish dhe arkeologësh kanë dekoduar mbishkrimet Cherokee, shkruar qindra vjet më parë në një shpellë në Alabama. Mbishkrimet brenda shpellës Manitou pranë Fort Payne janë dëshmia e parë e fisit syllabary, i cili përdorte simbole për të krijuar fjalë.

Ekspertët thonë se një mbishkrim përshkruan një lojë të ngjashme me lacrosse (lojë indiane).

Ata thonë se simbolet përshkruajnë një ndeshje të vitit 1828 dhe tregon lojtarët kur hyjnë në shpellë para ndeshjeve dhe gjatë ndërprerjes për ceremoni të veçanta.

Jan Simek, bashkëautor i një studimi mbi zbulimin, botuar në revistën ndërkombëtare arkeologjike "Antikiteti", tha: "Kjo është shumë më tepër se një lojë e thjeshtë. Është një ngjarje ceremoniale që shpesh vazhdon gjatë ditëve, duke u përqendruar në konkurrencën mes dy komuniteteve që epitomizojnë frymën dhe fuqinë e njerëzve dhe paraardhësve të tyre".

Fisi syllabary u krijua në vitet 1800 nga studiuesi Cherokee Sequoyah, i cili përfundimisht zhvilloi gjuhën zyrtare të shkruar të fisit.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin: AGIM DARDHA

